

**OFERTA REFERENCE PER SHITJEN ME SHUMICE TE
AKSESIT BITSTREAM**

nga

ALBtelecom Sh.a.

Qershor 2017

Versioni 1.2

(Përditësuar sipas VKD-ve të AKEP Nr. 2702 dhe 2704, date 22.12.2016
dhe VKD Nr. 13, date 04.05.2017)

PERMBAJTJA

PJESA E PERGJITHSHME

- 1 QELLIMI DHE OBJEKTI I OFERTES REFERENCE BITSTREAM
- 2 KUADRI LIGJOR
- 3 PERKUFIZIME DHE INTERPRETIME
- 4 HYRJA NE FUQI DHE AFATI
- 5 SHERBIMET BITSTREAM DHE KERKESA TE PERGJITHSHME
- 6 DETYRIME TE PERGJITHSHME TE PALEVE
- 7 SHERBIMET E REJA
- 8 FATURIMI DHE PAGESAT
- 9 ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE
- 10 GARANCIA FINANCIARE
- 11 SIGURIA DHE MBROJTJA E RRJETIT
- 12 OFRIMI, OPERIMI DHE MIREMBAJTJA
- 13 SHKELJA, PEZULLIMI DHE PERFUNDIMI I MARREVESHJES
- 14 KONFIDENCIALITETI
- 15 TE DREJTAT E PRONESISE INTELEKTUALE
- 16 RISHIKIMI
- 17 FORCA MADHORE
- 18 KUFIZIMI I PERGJEGJESISE
- 19 TRANSFERIMI I TE DREJTAVE DHE DETYRIMEVE
- 20 NJOFTIME
- 21 NDRYSHIME
- 22 MARREDHENIET E PALEVE
- 23 LIGJI I ZBATUESHEM DHE GJYKATA KOMPETENTE
- 24 DISPOZITA PERFUNDIMTARE

ANEKSET

- | | |
|---------|------------------------------------|
| ANEKS 1 | PERKUFIZIME |
| ANEKS 2 | PERSHKRIMI I PRODUKTTIT |
| ANEKS 3 | LISTA E CMIMEVE BITSTREAM |
| ANEKS 4 | FATURIMI DHE PAGESAT |
| ANEKS 5 | FORMULARI I GARANCISE |
| ANEKS 6 | MARREVESHJA E NIVELIT TE SHERBIMIT |

1 QELLIMI DHE OBJEKTI I OFERTES REFERENCE BITSTREAM

1. Qellimi i hartimit se kesaj Oferte Reference, eshte percaktimi i kriterëve dhe procedurave per rregullimin e marredhenieve ndermjet Albtelecom dhe Operatorit Perfitues lidhur me ofrimin e aksesit Bitstream Operatorit Perfitues sipas Licences/Autorizimit nga AKEP sipas percaktimeve te Ligjit Nr.9918 "Per komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar dhe akteve te tjera rregullatore ne fuqi.
2. Objekti i kesaj Oferte Reference eshte ofrimi i sherbimeve te Aksesit Bitstream per t'i krijuar mundesi Operatorit Perfitues tu ofroje perdoruesve fundore sherbime interneti duke perdorur aksesin ADSL ne infrastrukturen e rrjetit te Albtelecom.
3. Operatori Perfitues mund te kete opsione te pershtatshme per akses ne Bistream ne nivele te ndryshme te hierarkise se rrjetit Albtelecom, te specifikuara ne kete Oferte Reference, qe mund t'i mundesoje atij ndertimin e planeve te biznesit ekonomikisht te qendrueshme. Bazuar ne vendimin e AKEP nr. 2702, date 22.12.2016, Albtelecom ka detyrimin te jape akses me shumice broadband (bitstream) ne Nivel Ethernet (Opsioni 2) dhe ne Nivel IP (Opsioni 3).

2 KUADRI LIGJOR

Dispozitat e kesaj Oferte Reference jane hartuar ne perputhje me:

1. Ligjin Nr.9918 date 19.05.2008 "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar me Ligjin nr.102/2012; (ketej e tutje "Ligji 9918");
2. Rregulloren nr.19, date 14.06.2010 "Per Aksesin dhe Interkoneksionin" miratuar me Vendimin e Keshillit Drejtues te AKEP nr. 1300, date 14.06.2010, i ndryshuar (ketej e tutje "Rregullorja e Aksesit dhe Interkoneksionit").
3. Vendimin e Keshillit Drejtues te AKEP nr. 2701, date 22.12.2016 per "Miratimin e Dokumentit: Analize e tregjeve me shumice të aksesit broadband në Internet dhe Linjave me Qira) – Dokumenti Përfundimtar"
4. Vendimin e Keshillit Drejtues te AKEP, nr. 2702, date 22.12.2016, për Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe linjat me qera dhe masat përkatëse rregulluese"
5. Vendimin e Keshillit Drejtues te AKEP, Nr 2703, date 22.12.2016, per "Miratimin e Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumice te aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse- Dokumenti Përfundimtar"
6. Vendimin e Keshillit Drejtues te AKEP, Nr 2704, date 22.12.2016, per "Rregullimin e tarifave të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe linjat me qira"
7. Vendimin e Keshillit Drejtues te AKEP, Nr.13, date 04.05.2017 per "Shqyrtimin e ankimit administrative te sipermarresit Albtelecom Sh.A per vendimet e Keshillit Drejtues te AKEP me nr. 2703 dhe nr. 2704, date 22.12.2016.
8. Rregulloren nr 16, date 16.04.2010 "Per treguesit e cilesise" miratuar me VKD 1256, date 16.04.2010;
9. Rregulloren nr.18, date 11.06.2010 "Per procedurat e zgjidhjes se mosmarreshjeve", miratuar me VKD nr 1296, date 11.06.2010;
10. Rregulloren "Per Autorizimin e Pergjithshem" nr. 24, date 02.02.2012; si dhe cdo akt tjeter rregullator te nxjerre nga AKEP me ndikim ne kete Oferte Reference.

3 PERKUFIZIME DHE INTERPRETIME

3.1 Fjalet dhe shprehjet ne kete Oferte Reference te Aksesit Bitstream, pervecse kur konteksti shprehimisht e cileson ndryshe, jane sipas percaktimit te dhene ne Aneksin 1.

3.2 Pa cenuar te drejtat e Albtelecom, ne rast te nje mosmarreveshjeje apo paqartesis me termave te percaktuara ne ligjin dhe rregulloret e zbatueshme ne lidhje me kete Oferte Reference, do te zbatohet rendi i meposhtem i perparemise:

- o Ligji per Komunikimet Elektronike ne Republikën Shqiperise
- o Rregullorja per Aksesin dhe Interkoneksionin e AKEP.

3.3 Dokumentat e meposhtme jane pjese perberese e kesaj Oferte Reference Bitstream dhe, ne rastin kur ka mosperputhje ndermjet tyre, renditja sipas perparemise (pervec se kur shprehimisht cilesohet ndryshe) do te jete si me poshte vijon:

3.3.1 Pjesa kryesore e Ofertes Reference Bitstream qe perfshin:

- Aneksi 1 Perkufizimet
- Aneksi 2 Pershkrimi i Produktit
- Aneksi 3 Lista e cmimeve Bitstream te Albtelecom
- Aneksi 4 Faturimi dhe Pagesat
- Aneksi 5 Formulari i Garancise
- Aneksi 6 Marreveshja e Nivelit te Sherbimeve (SLA)

Termat dhe kushtet ne kete Oferte Reference mund te ndryshohen here pas here.

4 HYRJA NE FUQI DHE AFATI

1.1 Oferta Reference e Aksesit Bitstream hyn ne fuqi ne daten _____, date per te cilen eshte rene dakord mes paleve dhe eshte e vlefshme deri:

1.1.1 Ne kohen qe Operatorit Perfitues i mbaron afati i autorizimit, i revokohet autorizimi dhe Operatori Perfitues nuk ka marre autorizim tjeter zevendesues per ofrimin e rrjetit dhe/ose sherbimeve te komunikimeve elektronike per ofrimin e rrjetit ose sherbimeve te komunikimeve elektronike;

1.1.2 Ne zgjidhjen e marreveshjes sipas percaktimeve te kesaj Oferte Reference ne nenin 9.

5 SHERBIMET BITSTREAM DHE KERKESA TE PERGJITHSHME

5.1 Te Pergjithshme

Sherbimi Bitstream eshte nje produkt i shitjes me shumice qe perbehet nga dhenia e kapacitetit te transmetimit Operatorit Perfitues per t'i siguruar disa produkte XDSL te percaktuara, me te cilat Operatori Perfitues mund te shese Internet si dhe disa sherbime me vlere te shtuar nepermjet linjave te aksesit te Albtelecom.

5.2 Ndarja e produktit Bitstream

Pershkrimi i Bitstream paraqitet ne detaje te cilat jane te specifikuara si me poshte dhe ne "Pershkrimi i Produktit" pjese e kesaj Oferte Reference.

Produktet Bitstream ne varesi te nivelit te aksesit ne hierarkine e rrjetit grupohen si me poshte:

- Bitstream ne nivel DSLAM - Opsioni 1
- **Bitstream ne nivel Ethernet - Opsioni 2**
- **Bitstream ne nivel IP – Opsioni 3**
- Rishitje – Opsioni 4

Sipas dhe percaktimit te bere ne vendimin e AKEP (nr.2702/date 22.12.2016), Albtelecom ka detyrimin te jape akses me shumice broadband (bitstream) ne Nivel Ethernet (Opsioni 2) dhe ne Nivel IP (Opsioni 3). Ketu e ne vazhdim kjo Oferte reference pershkruan dhenien e aksesit per ofrimin e sherbimit sipas Opsionit 2 (nivel Ethernet) dhe Opsionit 3 (Nivel IP).

Pika e aksesit (pika e dorezimit te trafikut) percakton njekohesisht mundesine per kontrollin e parametrave teknike te sherbimit ADSL te ofruar tek perdoruesi fundor si dhe mundesine e perdorimit te rrjetit te tij Operatorit Perfitues, ne vend te perdorimit te rrjetit te Albtelecom.

Asnje nga palet ne kete Oferte Reference nuk eshte e detyruar te jape ose te autorizojte akses te sherbimeve te tjera pa qene e percaktuar dhenia e tyre ne Aneksin "Pershkrimi i Sherbimeve".

5.3 Operatori nuk do te perdore Sherbimet Bitstream ose te lejoje apo te pranoje qe cdo klient te perdore Sherbimin e Operatorit:

- 5.3.1 pervec se ne perputhje me kuadrin ligjor te zbatueshem, duke perfshire, por duke mos u kufizuar ne termat e cdo license/autorizimi te zbatueshme nga Operatori dhe Klienti (sipas aplikimit), kuadrin ligjor mbi privatesine, kuadrin ligjor mbi autoresine dhe te drejtat e pronesise intelektuale;
- 5.3.2 ne cdo menyre e cila shkel ligjin mbi kriminalitetin, ose te eksportoje ose riekportoje cdo material ne shkelje te ligjeve dhe rregullave te zbatueshme mbi kontrollin e eksportit;
- 5.3.3 pervec se ne perputhje me politikat e pranimit te perdorimit te cdo rrjeti te lidhur;
- 5.3.4 pervec se ne perputhje me cdo udhezim dhe/ose njoftim te dhene nga Albtelecom;
- 5.3.5 pervec se ne perputhje me dispozitat e pershkrimit te produktit te aplikuar sipas specifikimeve te kesaj Oferte Reference.

5.4 Operatori do te perfshije dhe ruaje ne kontratat e tij me Klientet, dispozitat te cilat nuk jane me pak te veshtira sesa ato te perfshira ne kete Oferte Reference. Operatori do te jete pergjegjes per zbatimin e gjitha ketyre dispozitave me Klientin.

5.5 Operatori pranon dhe bie dakord qe eshte ne pergjegjesine e vet Operatorit qe te siguroje, ashtu sic eshte kerkuar nga legjislacioni ne fuqi, se cdo Material i Operatorit dhe pales se trete eshte ne perputhje me te gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme. Pervec kesaj Operatori bie dakord qe ALBtelecom nuk ka asnje pergjegjesi lidhur me keto Materiale te Operatorit ose pales se trete.

5.6 Operatori do te demshperbleje plotesisht Albtelecom-in, punonjesit, sherbyesit dhe agjentet e tij, sipas rastit ndaj cdo detyrimi, humbjeje, kostoje, demtimi dhe shpenzimi (qe perfshin por nuk eshte i kufizuar ne tarifat ligjore te pranueshme) te shkaktuara nga ai dhe qe lindin direkt ose indirekt nga cdo pretendim ose veprim i ngritur ose kundervene ndaj ALBtelecom nga pala e trete e cila e pretendon se:

5.6.1 sherbimi eshte shfrytezuar ne shkelje te dispozitave te Pikes 5.3; ose

5.6.2 qe rezulton nga instalimi nga Operatori i cdo pajisje qe kate beje me Sherbimet

Bitstream;

5.6.3 Sherbimi i Operatorit është me defekt ose nuk mund të përdoret nga pala e treta;

5.7 Në mënyrë që Albtelecom të demshperblehet nga Operatori Perfitues, Albtelecom do të:

- a. Konfirmojë me shkrim qëllimin e tij për të shprehur pretendimin për demshperblim brenda gjashtedhjetë (60) ditëve nga marrja e faktit nga Albtelecom, ose në mënyrë të arsyeshme duhet të ishte në dijeni të këtyre faktit, dhe të përfshijë një shkrim të shkurtër për faktin lidhur me këtë konfirmim;
- b. Ndermarrë të gjitha hapat e nevojshme për të lehtësuar çdo humbje, pretendim, dëm, kosto, detyrim dhe shpenzime të tilla si dhe nuk do të shtojë, bejë kompromis, vendosë ose pranojë këto veprime pa ia komunikuar paraprakisht Operatorit Perfitues (që të mos refuzohet në mënyrë të pamotivuar);
- c. Lejojë Operatorin që të vetmbrohet nga këto pretendime, kërkesa, veprime, dëmtime, kosto dhe shpenzime, dhe
- d. Ofrtojë Operatorit tërë asistencën e duhur dhe nuk do të bëjë ndonjë ndërhyrje të demshme lidhur me mbrojtjen e këtyre pretendimeve, kërkesave, veprimeve, dëmtimeve, kostove dhe shpenzimeve.

6 DETYRIME TË PËRGJITHSHME TË PALEVE

6.1 Albtelecom do të ketë përgjegjësi për furnizimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e shërbimit Bitstream të Albtelecom:

- a) në rastin e Aksesit të përbashkët (ku është pjesë dhe last mile): nga modemi deri tek pikat e dorezimit (dmth në POP-et Rajonal IP (ADSL/ADSL2+), duke përfshirë instalimin e modemit dhe ndërhyrjen në modem.
- b) në rastin e Aksesit të plotë (ku last mile mund të mos jetë ekzistent): nga DP (distribution point) deri tek pikat e dorezimit (dmth në POP-et Rajonal IP (ADSL/ADSL2+), duke përfshirë "last mile" dhe instalimin e modemit. Gjithsesi, kjo përgjegjësi për pjesën fundore (last mile), do të gjykojë mes paleve rast pas rasti.

6.2 Operatori Perfitues duhet të sigurojë që instalimi i shërbimeve DSL të tij nuk prish interesin e shërbimeve të Albtelecom. Nëse abonenti i Operatorit Perfitues është i pënaqur me kualitetin e shërbimeve të Albtelecom gjatë ose si pasojë e instalimit të modemit dhe të shërbimeve të Operatorit Perfitues, ky i fundit do të korrigjojë problemin e shërbimit brenda një kohe të arsyeshme të rene dakord me parë ose të këtejve instalimin në gjendjen e tij origjinale.

6.3 Operatori Perfitues në zbatim të kërkesave teknike të ALBtelecom për instalimin e modemit duhet të provojë që defektet e instalimit janë jashtë rrejtës së tij.

6.4 Klientet e Operatorit Perfitues janë përgjegjës për instalimin e modemave dhe shërbimeve të tyre që operojnë mbi shërbimin Bitstream të ALBtelecom si dhe për çdo pajisje që Operatori Perfitues i bashkëngjitet shërbimit Bitstream të ALBtelecom jashtë pikave të terminimit të shërbimit.

7 SHËRBIMET E REJA

7.1 Operatori Perfitues mundet që në çdo kohë të kërkojë nga Albtelecom që të përfitojë një shërbim ose fasilitet të cilin pala e kërkuar (ofruesi) nuk e ka në dispozicion. Pala do të hyjë në bisedime me mirëbesim për ofrimin e këtij shërbimi.

- 7.2 Pala kërkuese do t'i sigurojë Palës se kerkuar (ofruese) me shkrim informacionin mbi kërkesen e tij. Pala e kerkuar (ofruese) do te konfirmoje me shkrim ose me E-mail marrjen e kërkeses, jo më vonë se pesë (5) ditë pune pranimit.
- 7.4 Bazuar ne mjaftueshmerine e informacionit ne shkresen e Pales Kerkuese, Pala e kerkuar (ofruese) do te konfirmoje me shkrim nese ajo bie dakord qe te ofroje sherbimin e pershkruar ne shkrese jo me vonë se dy (2) muaj nga marrja e kerkeses ne menyre te shkruar, pervec se ne rastet kur eshte rene dakord ndryshe nga Palet. Kur Pala ofruese nuk pranon për të përmbushur nje kërkesë të tillë ajo do të japë arsyet me shkrim për vendimin e saj në kohën e refuzimit.
- 7.5 Nëse Pala e kerkuar (ofruese) pranon per te ofruar shërbimin e ri, pala e kerkuar (ofruese) do të përpiqet për të rënë dakord mbi aspektet teknike dhe komerciale të Shërbimit të ri Bitstream brenda shtatëdhjetë e pesë (75) ditëve kalendarike, pas marrjes së kërkeses nga operatori kerkues, nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga Palët . Termat teknike dhe komerciale te pranuar do të përfshihen në rishikimin e radhes se ofertes reference te sherbimit Bitstream dhe do te dorëzohen ne AKEP për miratim/aprovim në përputhje me Kërkesat e Publikimit. Albtelecom, automatikisht do të zhvillojë një Marrëveshje të Nivelit të Shërbimit për Shërbimet e reja Bitstream kur është e nevojshme.
- 7.6 Nëse Pala e kerkuar (ofruese) nuk bie dakord për të siguruar shërbimin e përshkruar në kërkesen e Operatorit kerkues me arsyetimin se detyrimet e vendosura ndaj Pales se kërkuar (ofruese) në bazë të Rregullores se akses dhe interkoneksionit nuk përfshijnë detyrimin për të ofruar një shërbim të tillë, mund të konsiderohet se mes palëve ka lindur një mosmarrëveshje mes paleve dhe palët mund t'i referohen dispozitave te nenit 9. Megjithate negociatat per te rene dakort sipas kushteve të pranueshme mund të vazhdojnë, në pritje të zgjidhjes së mosmarrëveshjes
- 7.7 Albtelecom do të ofrojë shërbime të reja Bitstream për të gjithë operatorët dhe do të sigurojë njoftimin e tyre në përputhje me Kërkesat e publikimit.

8 FATURIMI DHE PAGESAT

- 8.1 Albtelecom do te faturoje Operatorin Perfitues, dhe ky i fundit do te kryej pagesen ndaj Albtelecom ne perputhje me dispozitat e parashikuara ne Aneksin 4.
- 8.2 Detyrimet ne Oferten Reference Bitstream nuk perfshijne TVSH-ne. Megjithate TVSH-ja do te kreditohet ne faturat qe rrjedhin nga kjo Oferte.
- 8.3 Faturat jane te detyrueshme dhe te pagueshme ne Leke. Faturat jane te pagueshme brenda tridhete (30) diteve kalendarike nga data e leshimit te fatures.
- 8.4 Nese Operatori Perfitues nuk kryen pagesat brenda afatit te percaktuar ne piken 8.3 te ketij neni, atehere do te aplikohet kamatvonesë ne masen 0.5% te vleres se shumes se detyruar per cdo dite kalendarike qe tejkalohet ky afat, por jo me shume se per 10 (dhjete) dite ne vijim.
- 8.5 Albtelecom do te siguroje faturat e te gjitha shumave sipas saj, te perlllogaritura ne perputhje me dispozitat e Aneksit 2 "Pershkrimi i produktit", Aneksit 3 "Lista e cmimeve Bitstream" dhe Aneksit 4 "Faturimi dhe Pagesat",

9 ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

- 9.1 Cdo mosmarreveshje mes paleve, pretendim ose kundërshtim, cdo shkelje ose pavlefshmeri e saj do te synohet te zgjidhet me mirekuptim midis tyre, perفشire parashikimet e Aneksit 4, nepermjet kontakteve, ne vazhdim referuar si Niveli 1.

- 9.2 Nese palet nuk arrijne te zgjidhin mosmarreveshjen ne Nivelin 1, brenda dy (2) javeve nga marrja e njoftimit me shkrim per mosmarreveshjen i derguar nga njera prej Paleve qe ka nenshkruar Marreveshjen e Aksesit Bitstream; ne zbatim te kesaj RO (ose brenda nje periudhe per te cilen palet kane rene dakort mes tyre ne Marreveshjen e Aksesit), secila pale gezon te drejten te kerkoje procedurat e zgjidhjes se mosmarreveshjes te parashikuara ketu duke i dhene njoftim pales tjetere. Pala qe jep njoftimin do te perfshije ne njoftim te gjitha detajet perkatese, duke perfshire llojin dhe masen e mosmarreveshjes. Palet do te realizojne nje perpjekje me vullnetin e mire per te negociuar dhe arritur zgjidhjen e mosmarreveshjes me mirekuptim mes tyre.
- 9.3 Duke dhene njoftimin, mosmarreveshja pershkallezohet ne Nivelin 2. Palet ne Nivelin 2 do te kryejne bisedime per te arritur zgjidhjen e mosmarreveshjes.
- 9.4 Nese perpjekjet e paleve per te zgjidhur mosmarreveshjen ne Nivelin 2 nuk perfundojne brenda dy (2) javeve nga pershkallezimi i mosmarreveshjes ne kete Nivel, secila pale nepermjet dhenies se njoftimit pales tjetere mund te pershkallezoje zgjidhjen e mosmarreveshjes nga AKEP ne perputhje me Rregulloren nr.18, date 11.06.2010 "Per procedurat e zgjidhjes se mosmarreveshjeve", ne vazhdim referuar si Niveli 3. Te gjitha detajet perkatese ne lidhje me natyren dhe masen e mosmarreveshjes do ti paraqiten AKEP se bashku me te dhenat perkatese qe jane rene dakord ose jo ne Nivelet 1 dhe 2.
- 9.5 Pavaresisht procedurave per zgjidhjen e mosmarreveshjes te parashikuara ne kete Oferte Reference te Aksesit Bitstream, secila nga palet ka te drejte qe ne cdo kohe t'ia adresojte ceshtjen AKEP per zgjidhje, ne perputhje me nenin 120, te Ligjit nr.9918, date 19.05.2008, "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar dhe kuadrin rregullator perkatese. Megjithate ne rast te ndonje mosmarreveshje te mundshme palet kane te drejte t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor te Tiranes.
- 9.6 Asnje nga parashikimet e kesaj Oferte Reference nuk do te parandaloje ndonjeren nga palet te:
- kerkoje (perfshire marrjen ose zbatimin) negociator, ose ndonje menyre, ose zgjidhje tjetere te ngjashme; ose
 - pavaresisht pikes 9.1, duke iu referuar drejtpersdrejti AKEP-it per zgjidhjen e mosmarreveshjes ne perputhje me Rregulloren nr.18, date 11.06.2010 "Per procedurat e zgjidhjes se mosmarreveshjeve", sipas rastit, pa kaluar me pare Nivelin 1 ose Nivelin 2 te negociatave ne perputhje me cdo te drejte, nese ndonjera ose te dyja palet mund te kerkojne nje vendim ose hapa te tjere te pershtatshem per zgjidhjen e mosmarreveshjes.
- 9.7 Fakti qe nje mosmarreveshje dergohet ne AKEP apo ne Gjykate, nuk i cliron palet nga detyrimet e tyre per te permbushur anagazhimet e tyre ne Marreveshjen e Aksesit te nenshkruar mes paleve, bazuar ne kete Oferte Reference.
- 9.8 Afatet kohore te parashikuara ne paragrafet 9.2 dhe 9.4 si me siper, mund te shtyhen me nje marreveshje midis paleve.
- 9.9 Procedurat e mesiperme nuk prekin asnje te drejte qe mund te lindi midis paleve ne lidhje me ndonje shkelje te dispozitave te Ofertes Reference Bitstream.
- 9.10 Nese lind nje mosmarreveshje ne lidhje me nje detyrim qe duhet paguar sipas fatures perkatese, Operatori gezon te drejten te mbaje pagesen per shumen perkatese (qe ka mosmarreveshje) duke i dhene Albtelecom-it nje njoftim te Nivelit 1, nese shuma e mosmarreveshjes eshte me e madhe se dhjete perqind (10%) e shumes totale te fatures qe duhet paguar dhe, nese mosmarreveshja me shkrim merret nga Albtelecom perpara dates se maturimit.

- 9.11 Nëse Operatori dëshiron të zbatojë dispozitat e këtij neni pas datës së maturimit të një fature të kontestuar, atëherë Operatori nuk gëzon të drejtën të mbajë një pjesë të shumës që duhet paguar. Operatori gëzon të drejtën të ngrejë një pretendim faturimi brenda njëzete e katër (24) muajve në fund të periudhës së faturimit të kontestuar.
- 9.12 Nëse ndonjëra nga paletat verë gabim faturimi që mund të ketë rezultuar gjatë ose pas periudhës së faturimit prej njëzete e katër (24) muajve, pala mund të kërkojë zgjidhjen e kësaj çështjeje me të gjitha materialet dhe/ose informacionin përkatës. Pas shqyrtimit dhe marrjes në konsideratë të informacionit të disponueshëm, paletat mund të leshojnë një faturë shtesë ose shumë tjetër sipas rastit.
- 9.13 Pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes, paletat do të leshojnë një pagesë ose shumë sipas rastit.

10 GARANCIA FINANCIARE

- 10.1 Ky është një kusht që paraprind këto Oferte Reference sipas të cilit përfituesi i aksesit do t'i mundësojë Albtelecom një garanci financiare e cila duhet të jetë leshuar nga një bankë e nivelit të dytë në Shqipëri. Vlera e Garancisë do të jetë një vlerë të cilën Albtelecom në opinionin e tij të drejtë dhe të arsyeshëm do ta konsiderojë të pershtatshme si siguri proporcionale kundër moszbatimit ose mosrespektimit të ndonjë prej parashikimeve të ketushme (përfshirë pa kufizim deshtimin për të kryer pagesat) nga përfituesi i aksesit, për sa kohë nuk është rënë dakort me shkrim ndryshe me Albtelecom.
- 10.2 Asnjë shërbim nuk do të aktivizohet, implementohet apo do të kryhen punime në lidhje me shërbimet e kërkuara, në rast se nuk depozitohet garancia financiare brenda afatit të përcaktuar në pikën 10.3 më poshtë.
- 10.3 Albtelecom mundet në çdo kohë, të kërkojë përfituesit të aksesit të vendosë në bankë ose garanci të tjera ose të ofrojë ndonjë formë tjetër të sigurisë financiare (p.sh. një depozitë) e cila në opinionin e drejtë dhe të arsyeshëm të Albtelecom është/janë të pershtatshme si siguri proporcionale kundër moszbatimit ose mosrespektimit të ndonjë prej parashikimeve të ketushme (përfshirë pa kufizim deshtimin për të kryer pagesat) nga përfituesi i aksesit. Albtelecom rezervon të drejtën për të trajtuar refuzimin për të vënë në dispozicion këto siguri/garanci brenda 30 ditëve (ose periudha më të gjatë nëse Albtelecom e sheh të arsyeshme) nga data e kërkesës së Albtelecom si shkelje të Ofertes Reference nga përfituesi i aksesit.
- 10.4 Shuma e Garancisë Financiare do të përlogaritet në mënyrë të tillë që të mbulojë detyrimet e Operatorit Përfitues për një periudhë dy-mujore. Për operatorët që kanë marrë akses, vlera e garancisë llogaritet mbi detyrimet e dy muajve të fundit, ndërsa për operatorët e rinj mbi parashikimin për dy muajt në vazhdim. Vlera e garancisë do të rishikohet çdo gjashtë muaj, si edhe në rastet e ndryshimeve të ndjeshme, të tilla konsiderohen ndryshimi i detyrimeve të dy muajve të fundit me mbi 30% më shumë se vlera e Garancisë Bankare.
- i. Vlefshmeria e Garancisë Financiare duhet të jetë për një periudhë minimale 12 (dymbëdhjetë) mujore, duke filluar nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes së Aksesit midis paleve, në përputhje me Oferten Reference. Një muaj përpara datës së përfundimit të periudhës së vlefshmerisë së garancisë, do të dorëzohet një Garanci Financiare e re. Në momentin e dorëzimit të Garancisë së Bankare të re, Albtelecom do t'i kthejë paletat tjetër Garancinë Bankare pararendesë. Deshtimi për të rinovuar apo dhënë një garanci të re, do të konsiderohet si shkelje e Marrëveshjes dhe i jep të drejtën Albtelecom të ndërprejë ofrimin e shërbimeve sipas Marrëveshjes.
 - ii. Garancia Bankare do të aktivizohet pjesërisht apo tërësisht në raste mospagese në kohë të

- detyrimeve te Operatorit Pefitues per sherbimet e aksesit te ofruara ne perputhje me kete Oferte Reference.
- iii. Pas perdorimit te Garancise Bankare, ajo do te duhet te rikthehet ne shumen e meparshme ose Operatori Perfitues duhet te ofroje nje garanci tjeter per te plotesuar apo zevendesuar garancine e perdorur, brenda 10 (dhjete) diteve pune nga perdorimi i garancise fillestare.

11 SIGURIA DHE MBROJTJA E RRJETIT

- 11.1 Secila pale eshte pergjegjese per operimin e sigurt te Rrjetit te saj dhe do te ndermarre te gjitha hapat e nevojshme ne operimin dhe implementimin e kesaj Oferte Reference te Aksesit Bitstream, si dhe do te siguroje qe rrjeti i saj:
- nuk rrezikon sigurine e shendetit te punonjesve, te kontraktoreve, agjenteve ose klienteve te Pales tjeter; ose
 - nuk demton, nderhyn, ose shkakton ndonje perkeqesim ne operimin e rrjetit te Pales tjeter.
- 11.2 Asnje nga palet nuk do te lidhe apo do te lejoje me dijeni lidhjen ne rrjetin e saj te ndonje pajisje ose aparati, duke perfshire por jo kufizuar, me ndonje pajisje terminimi qe nuk eshte miratuar, ne perputhje me Ligjin 9918 dhe Rregulloren Nr.25, date 14.06.2012 'Per pajisjet radio dhe fundore te telekomunikacioneve'.

12 OFRIMI, OPERIMI DHE MIREMBAJTJA

Procedurat per ofrimin e Sherbimeve Bitstream si dhe per operimin dhe mirembajtjen ne vazhdimesi do te percaktohen ne anekset perkates mbi Pershkrimin e Produktit dhe Marreveshjen e Nivelit te Sherbimeve.

13 SHKELJA, PEZULLIMI DHE PERFUNDIMI I MARREVESHJES

- Kushtet e percaktuara ne kete Oferte Reference nuk mund te kufizojne kohezgjatjen e sherbimeve te specifikuara aty. Ofrimi i sherbimeve te pershkruara ne kete Oferte Reference mund te pezullohet ose te perfundohet ne menyre te njenshme vetem ne rastet e meposhtme:
 - Kur Operatori Perfitues anullon aksesin tek sherbimet e ofruara;
 - Kur Operatori Ofrues perfundon kohen e veprimit te elementit te rrjetit te perdorur per ofrimin e aksesit tek Operatori Perfitues. Nje perfundim i tille nuk duhet te shkele detyrimet e vendosura mbi operatorin ofrues sipas nenit 42 te Ligjit. Operatori Ofrues duhet te informoje Operatorin Perfitues per nje perfundim te tille te pakten 6 muaj para kohe;
 - Kur Operatori Perfitues shkel dispozitat themelore te Ofertes Reference te Aksesit Bitstream. Operatori ofrues do te njoftoje menjehere AKEP-in per secilin prej ketyre rasteve;
 - Kur ka kriteret tjera te percaktuara ne ligj dhe aktet e leshuara per zbatimin e tij.
- Ne rast se rrjeti i njeres Pale ndikon negativisht ne funksionimin normal te rrjetit te Pales tjeter, ose paraqet rrezik per sigurine e ndonje personi, Pala tjeter mund te pezulloje, ne masen qe gjykohet e nevojshme, detyrimet e saj te lindura nga Marreveshja e Aksesit Bitstream e lidhur ne baze te kesaj Oferte Reference per aq kohe sa mendohet e arsyeshme per te siguruar funksionimin normal te sistemeve te saj, ose per te ulur shkallen e rrezikut ndaj sigurise. Ne cdo rast pala qe ndermerr masen e pezullimit njofton edhe AKEP.
- Nese ndonjera nga Palet ka kryer shkelje te Marreveshjes se Aksesit Bitstream te lidhur ne baze te kesaj Oferte Reference (pervec rasteve te parashikuara ne pikat 11 deri 14, Pala qe nuk ka

kryer shkeljen mund t'i dergoje nje njoftim me shkrim Pales tjeter qe ka kryer shkeljen (Njoftimin per Shkelje) duke specifikuar shkeljen dhe duke kerkuar qe ajo te korrigohet brenda:

- 3.1. Tridhete (30) dite pune nga dita e marrjes se njoftimit per shkelje ose,
 - 3.2. Ne raste emergjente (pervec detyrimeve finnanciare), brenda nje periudhe te tille te shkurter te cilen Pala qe nuk ka kryer shkelje mund t'a percaktoje ne menyre te arsyeshme.
4. Nese Pala qe ka kryer shkeljen nuk arrin t'a korrigoje kete shkelje brenda periudhes se percaktuar ne paragrafin 3, Pala tjeter mundet, derisa shkelja te jete korrigjuar, te pezulloje kryerjen e detyrimeve te saj te lindura nga Oferta Reference e Aksesit Bitstream ne masen qe konsiderohet e arsyeshme ne rrethana te tilla.
 5. Nese Pala qe ka kryer shkeljen nuk arrin te korrigoje kete shkelje brenda periudhes se percaktuar ne njoftimin per shkeljen, Pala tjeter mund t'a zgjidhe Marreveshjen e Aksesit Bitstream me ane te nje njoftimi me shkrim te derguar 3 muaj para tek Pala qe ka kryer shkeljen. Ne qofte se gjate periudhes 3 mujore te njoftimit Pala qe ka kryer shkeljen arrin te korrigoje plotesisht demin e shkaktuar nga kjo shkelje, Marreveshja e Aksesit bazuar ne kete Oferte Reference nuk do te zgjidhet edhe pas dergimit te nje njoftimi te tille.
 6. Secila nga Palet mund te zgjidhe Marreveshjen e Aksesit Bitstream ne cdo kohe duke i dhene pales tjeter njoftim me shkrim, nese pala tjeter ndodhet ne kushtet e:
 - 6.1. Perfundimit te afatit, anulimit dhe raste te tjera te perfundimit te parakohshem te licences ose autorizimit, kur nje license ose autorizim i tille kerkohet me ligj; ose,
 - 6.2. Likuidimit te vullnetshem ose te detyruar (pervec se per qellime riorganizimi ose bashkimi te bizneseve); ose eshte deklaruar ne falimentim; ose
 - 6.3. Mbylljes se aktivitetit para afatit te perfundimit te Marreveshjes; ose
 - 6.4. Njoftimit nga pala qe zgjidh Marreveshjen, per nderprerjen e Marreveshjes ne menyre te njeanshme per arsye te parashikuara ne kete Oferte Reference.
 7. Me zgjidhjen ose perfundimin e rregullt te Marreveshjes se Aksesit Bitstream secila nga Palet do te kete te drejte pas dergimit tek Pala tjeter te nje njoftimi paraprak brenda nje afati te arsyeshem, per te hyre ne ambientet e Pales tjeter me qellim kryerjen e procedurave te nevojshme per cmontimin dhe rimarrjen ne dorezim te pajisjeve, impianteve ose aparaturave qe i perkasin kesaj te fundit ose nje Pale te trete te instaluar nga ose per ate Pale, me kusht qe Pala qe kerkon te hyje ne keto ambiente te jape nje njoftim tjeter brenda nje afati te arsyeshem duke kerkuar qe Pala tjeter te kryeje cmontimin dhe kthimin e ketyre pajisjeve, impianteve dhe aparaturave dhe te hyje ne keto ambiente vetem ne rast se vete ajo Pale nuk e ka bere kete. Pala ne ambientet e se ciles jane instaluar keto pajisje, impiante dhe aparatura dote kompensoje Palen tjeter per cdo pajisje, impiant dhe aparature qe i perket Pales tjeter ose ndonje pale te trete, te cilat nuk dorezohen ne kushte te mira (nje shkalle e lehte amortizimi eshte e pranueshme). Asnjera nga Palet nuk do te konsiderohet pergjegjese per ndonje demtim te pajisjeve, impianteve dhe aparaturave qe i perkasin Pales tjeter ose nje Pale te trete, i cili eshte shkaktuar nga moskryerja e procedurave te nevojshme te mirembajtjes nga Pala tjeter ose Pala e trete.
 8. Pa cenuar te drejtat e Paleve, me zgjidhjen e Marreveshjes se Aksesit Bitstream, secilanga Palet do t'i rimburoje Pales tjeter shumat periodike te paguara (nese ka te tilla) per periudhen e kohes qe tejkalon afatin e vlefshmerise se kesaj Oferte Reference.
 9. Zgjidhja apo perfundimi i vlefshmerise se Marreveshjes se Aksesit Bitstream nuk do te nenkuptoje shkarkimin e pergjegjesis se njeres nga Palet e Marreveshjes per shkeljen e

ndonjeres prej dispozitave te Marreveshjes se Aksesit Bitstream dhe do te behet pa cenuar te drejtat dhe detyrimet e asnjeres prej Paleve, te cilat kane lindur dhe jane akumuluar deri ne daten e zgjidhjes se kesaj Marreveshjeje ose perfundimit te saj te rregullt.

10. Pavaresisht sa parashikohet ne kete nen nr.13 per nderprerje apo zgjidhje te Marreveshjes, secila pale ka te drejte te paraqese ceshtjen ne AKEP per zgjidhjen e Marreveshjes.
11. Ne rast se ndonje nga palet deshton te kryeje pagesat e sherbimeve, ne perputhje me percaktimet e dhena ne nenin 8 dhe 10, dhe Aneksin 4 "Faturimi dhe Pagesat" per faturat e emetuara ne perputhje me percaktimet e Marreveshjes se Aksesit bazuar ne kete Oferte Reference, nje shkelje e tille do te konsiderohet Shkelje Pagesash, dhe pala qe nuk eshte ne shkelje ka te drejte:
 - 11.1 Te aktivizojte ekzekutimin e menjehershem te Garancise Financiare te vendosur ne favor te saj nga pala tjetere sipas percaktimeve ne nenin 8 "Faturimi dhe Pagesat" dhe nenin 10 "Garancia Financiare", dhe me pas te njoftoje me shkrim dhe/ose me email palen tjetere duke kerkuar, qe brenda 10 (dhjete) diteve kalendarike nga data e perfundimit te afatit 10 (dhjete) ditore te kamatevoneses:
 - a. te plotesoje vleren e Garancise Financiare pas perdorimit nga pala jo ne shkelje, ne vleren e meparshme ose ne nje vlere te rivleresuar nga pala jo ne shkelje;
 - b. te paguaje diferencen midis vleres se detyrimit financiar perkates dhe Garancise Financiare, ne rast se Garancia Financiare nuk mbulon vleren e ketij detyrimi.
 - 11.2 Te pezulloje menjehere me perfundimin e afatit 10 (dhjete) ditore te kamatevoneses, ofrimin e sherbimeve te aksesit Bitstream, duke njoftuar palen ne shkelje per masen e marre, dhe me kalimin e 10 (dhjete) diteve nga perfundimi i afatit 10 (dhjete) ditore te kamatevoneses, te zgjidhe Marreveshjen e Aksesit Bitstream.
12. Ne rast se pala ne shkelje korrigjon shkeljen brenda afatit kohor te percaktuar sipas pikes 11.1, pala jo ne shkelje nuk do te nderprese aksesin apo zgjidhe Marreveshjen Bitstream, ne rast se nuk ndodhemi ne kushtet e pikes 14.
13. Deshtimi apo refuzimi nga pala ne shkelje per te korrigjuar shkeljen e pagesave brenda afatit kohor te percaktuar sipas pikes 11.2, i jep te drejten pales jo-ne shkelje te pezulloje ofrimin e sherbimeve Bitstream dhe me kalimin e 10 (dhjete) diteve kalendarike nga perfundimi i afatit 10 (dhjete) ditore te kamatevoneses, te zgjidhe Marreveshjen e Aksesit Bitstream duke bere njoftimin me shkrim dhe/ose me email 5 (pese) dite perpara dates se berjes efektive te nderprerjes perfundimtare te aksesit bitstream (zgjidhjes se Marreveshjes).
14. Ne rast se, nje pale qe eshte njoftuar per tre shkelje te pagesave te meparshme, ndodhet ne kushtet e nje shkelje pagesash per here te katert brenda nje periudhe 24 (njezet e kater) mujore, Marreveshja e Aksesit Bitsream bazuar ne kete Oferte Reference mund te zgjidhet nga pala jo ne shkelje nepermjet nje njoftimi me shkrim derguar pales ne shkelje. Shkeputja e aksesit do te realizohet 30 (tridhjete) dite pas dates se dergimit te njoftimit. Zgjidhja (shkeputja) mund te kryhet pavaresisht nese Shkelja e pagesave eshte korrigjuar gjate kesaj periudhe kohore. Ddetyrimet per pagesa e pakryera mbeten/ngelen edhe pas zgjidhjes se marreveshjes se aksesit Bitstream.
15. Albtelecom/Operatori Perfitues ka detyrimin te njoftoje AKEP menjehere ne secilin prej ketyre rasteve te permenduar ne kete nen si dhe per raste e nderprerjeve per shkak te forcave madhore dhe emergjences.

14 KONFIDENCIALITETI

- 14.1 Per zbatimin e Marreveshjes se Aksesit Bitstream, palet do te mbajne Informacionin Konfidencial kur jepet si "i tille" dhe do te angazhohen qe stafi dhe drejtuesit, punonjesit, e agentet do te informohen per rendesine e ruajtjes se informacionit dhe nuk do t'ja mundesojne kete informacion paleve te treta.
- 14.2 Operatori Perfitues do te angazhohet si dhe do siguroje Albtelecom qe te dhenat dhe/ose informacioni nuk do disponohet nga personat e pa kualifikuar ose jo ekspert qe mund t'i transformojne ose te keqinterpretojne informacionin apo te dhenat e ofruara nga Albtelecom.
- 14.3 Pala qe disponon Informacion Konfidencial do te kufizojte permbajtjen e te dhenave per personat qe per nga natyra e punes duhet te njihen me permbajtjen e Informacionit Konfidencial. Informacioni Konfidencial do te perdoret ne masen e nevojshme vetem per qellimin e lidhjes dhe zbatimit Marreveshjes se Aksesit Bitstream per sherbimet e ofruara nga Albtelecom.
- 14.4 Perjashtohen nga rregulli i klauzoles te mesiperme, informacioni ose cdo dokument tjetër:
- qe eshte siguruar ne menyre te ligjshme nga te tretet;
 - qe njihej si i ligjshem per t'u publikuar nga marresi ne ditën e marrjes;
 - qe eshte ose behet publik jo ne kundërshtim me keto dispozita te konfidencialitetit;
 - qe eshte i lire ne zoterim te publikut ose behet publik nga perfaqesuesit e Albtelecom-it;
- 14.5 Per qellim te Marreveshjes se Aksesit nese njera nga palet ndodhet para faktit te publikimit te dhenave sipas pikave 14.4.a dhe 14.4. c duhet te njoftoje sa me shpejt te jete e mundur perfaqesuesit e Pales tjetër.
- 14.6 Ne cdo rast, palet jane te detyruara te vazhdojne te respektojne kushtet e konfidencialitetit sipas ketij neni deri ne 5 (pese) vjet pas perfundimit ose nderprerjes se njeanshme te saj.

15 TE DREJTAT E PRONESISE INTELEKTUALE

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne Marreveshjen e Aksesit Bitstream, te Drejtat e Pronesise Intelektuale do te ngelen pronesi e pales qe ka krijuar ose zoteruar keto te drejta, dhe asnje parashikim i Marreveshjes Bitstream nuk do te konsiderohet se njera pale i akordon pales tjetër ndonje te drejte, titull ose licence te te Drejtave te Pronesise Intelektuale, dhe asnje parashikim i Marreveshjes nuk do te konsiderohet si kufizim i te drejtave te pales tjetër per te zoteruar, perdorur, gezuar, licence, percaktim ose transferim i Pronesise se saj Intelektuale.

16 RISHIKIMI

- 16.1 Njera nga palet mund kerkoje te modifikojte Marreveshjen e Aksesit Bitstream duke derguar nje njoftim per rishikim tek pala tjetër, nese:
- 16.1.1 Autorizimi i njerës nga palet modifikohet thelbesisht (me ane te nje modifikimi te autorizimit ose me zevendesim te tij); ose,
 - 16.1.2 Detyrimet e Albtelecom sipas Rregullores per Akses dhe Interkoneksion modifikohen thelbesisht; ose,
 - 16.1.3 Ligji ose rregulloret per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise pesojne ndonje ndryshim thelbesor; ose,
 - 16.1.4 Oferta Reference e Aksesit Bitstream permban dispozita te qarta per Rishikimin ose Operatorët e Autorizuar bien dakort me shkrim se dote kete nje Rishikim; ose,
 - 16.1.5 Ndodh nje ndryshim thelbesor, qe perfshin nxjerrjen e akteve detyruese nga ndonje organ rregullator, gje qe ndikon ose pritet te ndikojte mjaftueshem ne aspektin komercial ose teknik te marreveshjes se Aksesit Bitstream; ose,
 - 16.1.6 Ndodh nje ndryshim ne Sherbimet e Aksesit te ofruara nga Albtelecom sipas kesaj

Oferte Reference.

- 16.1.7 Te drejta dhe detyrimet të parashikuara në Marrëveshjen e Aksesit Bitstream janë atribuar ose transferuar nga Albtelecom.
- 16.2 Njoftimi për Rishikim paraqet në mënyrë të detajuar çështjet që do të diskutohen midis Albtelecom dhe Operatorin Perfitues. Pala që kërkon modifikimet/shtesat do të njoftojë Palen tjetër në lidhje me të brenda një minimumi prej 30 ditësh kalendarike para datës së propozuar për negociatën.
- 16.3 Me dërgimin/marrjen e një njoftimi për Rishikim, Albtelecom dhe Operatori Perfitues do të fillojnë menjëherë negociatat për zgjidhjen e çështjeve të mirëkuptim mes paleve me qëllim rinien dakort në lidhje me modifikimet/shtesat përkatëse të Marrëveshjes së Aksesit Bitstream.
- 16.4 Nëse Palet nuk arrijnë një Oferte Reference pas një periudhe maksimale prej 2 muajsh nga data e marrjes së lajmerimit për shqyrtim, në lidhje me objektin e njoftimit për Rishikim, atëherë do të jenë të zbatueshme parashikimet e nenit 9 (Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve).
- 16.5 Për të evituar ndonjë keqkuptim të mundshëm, Palet bien dakort se pavarësisht nga dërgimi/marrja e njoftimit për Rishikim, Oferta Reference e Aksesit Bitstream do të vazhdojë të jetë në fuqi.

17 FORCA MADHORE

- 17.1 Asnjë nga palet nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë shkelje të kësaj Oferte Reference nëqoftëse ajo shkaktohet nga forca madhore, ndonjë fatkeqësi natyrore, lufte, gjendje të jashtëzakonshme në shkallë kombëtare ose lokale, ose nga çdo lloj fenomeni tjetër i cili deklarohet dhe njihet si forca madhore nga Autoriteti Qeverisës, Parlamenti Shqiptar, ose Gjykata e Lartë.
- 17.2 Palet, gjithashtu, nuk dote mbajnë përgjegjësi për dëmet të rrjedhura për shkak të cilat megjithatë nuk çështen si Force Madhore, mund të konsiderohen si të tilla, pasi nuk mund të shmangen edhe sikur palet të kenë dijeni paraprake për të. Pala e prekur nga një ngjarje e tillë do të njoftojë menjëherë palen tjetër për shkallën dhe kohezgjatjen përfaqësisht të kësaj pamundësie për të përmbushur detyrimet e saj.
- 17.3 Me pushimin e vonësave ose të humbjeve që kanë rezultuar nga kjo ngjarje, pala e prekur do të njoftojë palen tjetër për këtë ndërprerje. Nëqoftëse si rezultat i kësaj ngjarje, përmbushja nga ndonjëra pale e detyrimeve të saj për shkak të Marrëveshjes së Aksesit Bitstream, preket vetëm pjesërisht, atëherë kjo pale mbetet përgjegjës për realizimin e detyrimeve të paprekura.

18 KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË

- 18.1 Detyrimet e Paleve në lidhje me Sherbimet e Aksesit Bitstream përcaktohen nga legjislacioni në fuqi, autorizimet e tyre dhe Oferta Reference e Aksesit Bitstream. Asnjë nga palet nuk do të jetë përgjegjës përtej detyrimit për të ushtruar kujdes dhe vëmendje të një operatori kompetent telekomunikacionesh për gjatë ushtrimit të detyrimeve të tij në përputhje me Marrëveshjen e Aksesit Bitstream bazuar në këtë OR.
- 18.2 Palet nuk do të konsiderohen përgjegjës në rast të ndonjë kufizimi ose ndërprerje të plotë të Aksesit Bitstream, nëse kjo gjykohet e nevojshme nga një organ kompetent i telekomunikacionit dhe/ose organ gjyqësor. Në këtë rast, secila nga Palet është e detyruar të njoftojë në kohë Palen tjetër, duke i vënë në dispozicion të gjithë informacionin e mundshëm.

18.3 Asnje nga palet nuk do te jete pergjegjese ndaj pales tjeter ne marredhenie kontraktore apo jashte saj, apo per humbje (direkte ose indirekte) te fitimeve, biznesit, fitimeve te paraprira, shpenzimeve te harxhuara, kostove apo per ndonje humbje indirekte apo te passjelle qe lind ne lidhje me operimin Marreshes se Aksesit Bitstream bazuar ne kete OR, sido qe kjo humbje te kete ndodhur/ardhur.

19 TRANSFERIMI I TE DREJTAVE DHE DETYRIMEVE

19.1 Pavec se kur palet kane rene dakord ndryshe me shkrim, Albtelecom dhe Operatori Perfitues nuk kane te drejte te transferojne asnje te drejte ose detyrim qe rrjedh nga Oferta Reference e Aksesit Bitstream tek palet e treta, pa marre me pare miratim me shkrim nga Pala tjeter.

19.2 Me njoftimin e Pales tjeter, por pa qene nevoja per miratimin e saj, secila nga Palet ka te drejte te transferoje te drejtat dhe detyrimet e saj konvencionale tek nje pale e trete si rezultat i transferimit te autorizimit perkates qe zoteron per ofrimin e sherbimeve te komunikimeve elektronike dhe/ose ndryshimit te kontrollit ne Kompanine e saj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, me kusht qe pala e trete te marre persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet kontraktuale te Pales qe i transferon keto te drejta dhe detyrime. Cdo kosto e gjeneruar nga ky moment e ne vazhdim do te jete plotesisht ne pergjegjesine e kesaj pale te trete.

20 NJOFTIME

Çdo korrespondence, njoftim, kerkese, oferte, propozim, udhezim ose komunikime te tjera ose dokument per t'u dhene ne lidhje me kete Oferte Reference nga nje pale, duhet te jete me shkrim, te dergohet zyrtarisht ne adresat e percaktuara saktesisht nga palet dhe duhet qe detyrimisht te permbaje:

- Adresa e Selise se Subjektit _____
- Personi i autorizuar per marrjen e njoftimit
- Nr. Telefoni (Fix/Mobil)
- Fax (24/24 ore)
- E-mail

(A) Ne rast te njoftimeve per ALBTELECOM Sb.a:

Albtelecom Sh.a.
Adresa: Autostrada Tirane – Durres, km7, Kashar, Tirane, Shqiperi
Ne vemendje te: Drejtoria e Marredheneve ndermjet Operatoreve

Vangjush Perdhiku: Drejtor:
vangjush.perdhiku@albtelecom.al Telefon: 042290122

Ardiana Olloni: Account manager:
ardiana.olloni@albtelecom.al Telefon: 042290102

(B) Ne rast te njoftimeve per Operatorin Perfitues

Operatori Perfitues:
Adresa: _____
Ne vemendje te Z. _____
Telefon: +355 _____ Fax: +355 _____
Cel: +355 _____

e-mail: _____@_____,
Kutia Postare

20.2 Ne rastin e dergimit me sherbim postar do te quhet automatikisht i derguar me marrjen e konfirmimit te sherbimit postar dhe kur dergohet dorazi, me nenshkrimin e pales marrese.

21 NDRYSHIME

- 21.1 Cdo ndryshim, perfshire ketu ndryshimet e c mimeve, ne Marreshjen e Aksesit Bitstream te Albtelecom e nenshkruar ne zbatim te kesaj RO, i percaktuar nga vendimet, udhezimet, percaktimet, detyrimet specifike, masat dhe kerkesat e AKEP ose autoritet tjeter kompetent apo statutor, apo i prezantuar permes kriterave te publikimit do te konsiderohet automatikisht i perfshire ne kete Marreshje te Aksesit Bitstream me efekt te menjehershem ose nga kjo date alternative sic percaktohet nga AKEP ose autoritet tjeter.
- 21.2 Pavaresisht Nenit 21.1, perfshirja automatike e ndryshimeve ne Marreshjen e Aksesit Bitstream do te zbatohet vetem per Palen qe eshte subjekt i detyrimeve dhe ne masen qe autoriteti urdherues ka kompetencen te vendose keto detyrime.
- 21.3 Te gjitha ndryshimet e tjera ne kete Oferte Reference do te behen me shkrim dhe Palet do te jene dakort qe ato te jene te vlefshme dhe te detyrueshme per Palet, perfshire ketu cdo ndryshim ne lidhje shtimin e Sherbimeve Bitstream.

22 MARREDHENIET E PALEVE

Marredheniet midis Paleve do te jene ato te kontraktoreve te pavarur. Asgje ne kete Oferte Reference nuk do te percaktoje Palet si agjente, partnere, bashkepunuese te njera tjetres. Asnjera nga Palet nuk ka te drejte te kete autoritet, te shprehur apo te nenkuptuar, per llogari te, ose ne emer te ndonje pale tjetere, as te drejten te vendose detyrime ndaj Pales tjetere. Asnjera nga Palet nuk do te mbaje pergjegjesi permes deklarave, veprimeve apo heqjeve ndaj Pales tjetere qe eshte e paautorizuar dhe bie ne kundërshtim me dispozitat e kesaj Oferte Reference.

23 LIGJI I ZBATUESHEM DHE GJYKATA KOMPETENTE

Oferta Reference e Aksesit Bitstream dhe te gjitha ceshtjet qe kane te bejne me te do te rregullohen, interpretohen ne perputhje me Ligjin 9918 date 19.05.2008 dhe kuadrin ligjor e rregullator ne fuqi ne Republiken e Shqiperise dhe organi gjyqesor kompetent dote jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

24 DISPOZITA PERFUNDIMTARE

- 24.1 Pavleshmeria ose pamundesia per tu zbatuar ndonje pjese e Ofertes Reference te Aksesit Bitstream nuk do te cenoje dhe as nuk do te ndikojte ne vlefshmerine ose zbatimin e pjeses tjetere te kesaj Oferte, pervec se kur ky fakt rrjedh si pasoje e ndonje vendimi ne forme te prere nga Gjykata kompetente ose si vendim i arsyetuar ligjrisht i AKEP.
- 24.2 Asnje ndryshim, heqje apo shtim dispozitash te Ofertes Reference te Aksesit Bitstream dhe anekseve te saj, nuk do te jete i vlefshem nese nuk nenshkruhet rregullisht nje amendament nga palet i cili do te jete pjese integrale e Marreshjes se Aksesit, perjashtuar rasteve te parashikuara per perditetim automatik kundrejt njoftimit perkates te paleve sipas vete Marreshjes se Aksesit Bitstream na zbatim te kesaj RO.

24.3 Oferta Reference e Aksesit Bitstream dhe anekset e saj hartohen ne gjuhen shqipe, ne tre kopje, nga nje per secilen pale dhe nje per t'u depozituar prane AKEP.

24.4 Cdo perkthim i Ofertes Reference te Aksesit Bitstream, i bere nga palet per nevojte negociimi ose zbatimi, duhet te noterizohet prane nje Noteri Publik shqiptar por pa marre fuqine dhe cilesine e nje ekzemplari original.

ALBTELECOM Sh.a

OPERATORI PERFITUES sh.a/sh.p.k

Tahsin Yilmaz

Administrator

Administrator

ANEKSI 1 PERKUFIZIME

Ne kete Oferte Reference, fjalet dhe shprehjet do te kene kuptimet e meposhtme:

"Ligji 9918" eshte ligji nr.9918, dt. 19.05.2008, i ndryshuar.

"AKEP" eshte Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

"Data aktuale e dorezimit" eshte data kur do te filloje Sherbimi Bitstream Backhaul.

"Porta Bitstream" eshte ofrimi i nje Produkti ne nje numer telefoni sherbimi/CLI (identifikimi i numrit thirres).

"Transferta e Portes" eshte sherbimi qe do te perdoret nga Operatori Perfitues per te transferuar nje Porte Bitstream nga rrjeti i Operatorit Humbes tek rrjeti i Operatorit Perfitues ne nje Produkt Bitstream te zgjedhur nga Operatori Perfitues.

"Sherbimet Bitstream" jane sherbimet e aksesit te Bitstream dhe Bitstream Backhaul te ofruara sipas kesaj Oferte Reference dhe per te cilat Operatori ka hartuar Programe Sherbimi.

"Migrimi" eshte transferta aktuale per te cilen nje porosi behet ndermjet sherbimeve te pershtatshme.

"Klienti" eshte personi i cili abonohet ne Sherbimin e Operatorit, duke perfshire por jo duke u kufizuar vetem tek perdoruesit dhe rishitesit.

"Operatori Perfitues" eshte Operatori i autorizuar nga Albtelecom per Sherbimin Bitstream sipas Marreveshjes Bitstream, dhe perfiton nje Klient permes sherbimit te Transfertes se Portes Bitstream ose Migrimeve.

"Ne Sherbim" eshte lidhja ekzistuese e aksesit ku Albtelecom merr qera nga nje klient ose operator tjeer i autorizuar.

"Te drejtat e Pronesise Intelektuale" eshte cdo patente, aplikim per patente, te drejten e autorit, te drejten morale, emrin tregtar, marken tregtare, marken e sherbimit, sekretin tregtar, te drejten e autorit dhe cdo aplikim apo e drejte qe aplikon per regjistrim, emrat domain, logo, skica, slogane, dhe asetet e paprekshme, programet kompjuterike ose aplikimet, informacionet mbi pronesite e prekshme apo e paprekshme, njohurite specifike, proceset e pronesise, formularet, algoritmat, ose cdo e drejte tjeter e pronesise intelektuale, e regjistruar ose jo, apo e krijuar e para ose me pae, ne ose pas Dates se Fillimit.

"Afati minimal" eshte periodha minimale gjate se ciles Operatori eshte i gatshem te mbaje dhe te paguaje per Produkt te Ri te Porositur ne Porten Bitstream. Kjo periodhe do te filloje ne daten qe Albtelecom fillon faturimin per kete Produkt ne Porten Bitstream dhe do te vazhdoje dhe gjashte muaj pas kesaj periodhe.

"NTU" eshte Njesia e Perfundimit te Rrjetit.

"Instalimi manual i NTU" eshte dokumenti i cili percakton pergjegjesite e te gjitha paleve te perfshira ne akses, ofrimin dhe riparimin e llojeve te ndryshme te sherbimeve qe perdorin Rrjetin e Aksesit te Albtelecom. Ne menyre specifike ky dokument percakton procedurat dhe standartet per te cilat cdo pale duke perfshire Klientin, instalon NTU ne ambientet e Klientit per te ofruar Bitstream me linja bakri.

"Sherbimi i Operatorit" do te jete sherbimi i ofruar nga Operatori Kerkues per Klientin qe perdor Sherbimin.

"Produkti" eshte cdo variant i produkteve te percaktuara ne pershkrimin e Produktit i cili mund te rishikohet dhe ripublikohet here pas here.

"Sherbimi" do te jete sherbimi i Albtelecom i njohur si Sherbimi Albtelecom Bitstream i cili pershkruhet ne menyre me specifike ne "Pershkrimi i Produktit".

ANEKSI 2 PERSHKRIMI I PRODUKTIT

1. PERSHKRIMI I QELLIMIT

1.1 Te pergjithshme.

Albtelecom deshiron qe te behet nje nder ofruesit e komunikimit te unifikuar ne tregun Shqiptar si dhe me gjere ne ate rajonal. Ne menyre qe te permbushet vizioni i kesaj sfide, Albtelecom ka investuar per zgjerimin dhe permisimin e aksesit te saje, transportit, rrjetit te transmetimit me synimin e permiresimit te ekperiencave te klientit.

Bazuar ne detyrimet e vendosura nga AKEP, Albtelecom do te ofroje sherbimin "Aksesi Bitstream" nepermjet teknologjise se ADSL/ADSL 2+, dhe akses te metejsheem te rrjetit qendror. Ofrimi i ketij sherbimi eshte nje detyrim rregullator i bazuar ne VKD Nr. 2702, date 22.12.2016, i cili percakton Albtelecom si operator me fuqi te ndjeshme ne treg (SMP) per aksesin ne infrastrukturen fizike nga vendndodhje fikse, LLU (local loop unbundling) dhe aksesin Broadband si dhe vendosjen e masave rregulluese.

1.2 Objekti i Sherbimit

Cdo operator alternativ ne Shqiperi mund te ofroje akses broadband ndaj klienteve te tij (te operatorit alternativ), duke shfrytezuar aksesin e Albtelecom dhe teknologjine kryesore te rrjetit baze. Sherbimi (duke perfshire mbeshtetjen, riparimin e difekteve, etj) i ofruar perdoruesit fundor eshte pergjegjesi e operatorit alternativ, pasi modemi eshte kufiri i ndarjes.

Sherbimi i aksesit Bitstream do te ofrohet ne dy menyra te ndryshme, duke mbuluar keshtu te gjitha nyjet e rrjetit IP/MPLS te Albtelecom. Sherbimi i aksesit Bitstream bazohet ne disponueshmerine e larte te sherbimit, cilesine e larte te sherbimit te rrjetit AT, prezencen e rrjetit ne mbare vendin, dhe nje kapacitet te gjere te disponueshem bandëidh.

Edhe nese sherbimi eshte nje sherbim shumice, Albtelecom synon qe te kete nje perdorim te fuqishem te ketij sherbimi ne zonat ku potenciali i tregut eshte i madh.

1.3 Kerkesat e tregut

Tiparet kryesore te kerkuara per sherbimin e internetit jane: sherbim i avancuar, i sigurte, i kontrollueshem, kosto efektive dhe akses internet kudo.

Kerkesat aktuale te operatoreve alternativ mund te permbliidhen si me poshte:

- Kosto e larte per dhenie aksesi dhe krijim infrastrukture rrjeti baze.
- Veshtiresi ne te drejtat ligjore dhe te pronesise ne vendosjen e infrastruktures se rrjetit.
- Demtim dhe vjedhje e rrjetit.
- Paqendrueshmeri ne raportin e shpejtesise se uplinkut.
- Disa operatore jane bazuar ne qytet/rajone te caktuara (pa asnje synim per tu zgjeruar).

Mundesite e ALBtelecom:

- Operoret alternative lokal mund ta njohin ndonjehere me mire tregun e lokalizuar,
- Operoret alternative nuk kane kapital qe te investojne ne rrjetet e perparuara,
- Shfrytezimi i kapaciteteve dhe portave te paperdorura,
- Kontroll me i mire i rishitjes se trafikut.

2. PERSHKRIMI I DETAJUAR I SHERBIMIT

Sherbimi i aksesit Bitstream eshte nje sherbim i ofruar per perdoruesit fundore per te cilin operatori alternativ i paguan Albtelecom-it. Operatori alternativ mundet qe nepermjet sherbimit te aksesit Bitstream te perzgjedhe aksesin ne rrjetin Albtelecom (ne dy menyra te ndryshme te ofruara), si dhe do ti rishitet perdoruesit fundor paketa e sherbimit te internetit te operatorit alternativ. Operatori alternativ mundet gjithashtu te shese ne te ardhmen nepermjet aksesit te Albtelecom disa sherbime me vlere te shtuar, qe do te ofrohen ne te ardhmen.

Ne princip, operatori alternative detyrohet qe ti ofroje paketen e aksesit perdoruesve te tij fundor me karakteristika dhe vecori si sherbimet e Albtelecom. Gjithashtu operatori mund te kerkoje te ofroje pakete per abonente fundore me vecori te tjera nepermjet opsioneve te sherbimit Bitstream (Opsioni 2-Nivel Ethernet ose Opsioni 3-Nivel IP).

Sherbimi Bitstream do te jete i disponueshem vetem ne zonat ku Albtelecom ka migruar plotesisht ne teknologjine NGN. Ne rastet kur operatori alternativ kerkon sherbime ne zonat e pambuluara nga NGN, ky do te konsiderohet si rast i vecante nga plani i saj i zhvillimit, dhe kostoja e infrastruktures do te ndahet ndermjet Albtelecom dhe operatorit alternativ sipas kapaciteteve te blera nga operatori alternativ.


Operatori Alternativ (apo ISP-te) jane pergjegjes per sherbimin ndaj perdoruesit fundor.

Sherbimi Bitstream do t'iu ofrohet te gjithe Operatoreve Alternative/ISP te cilet kane Autorizimet perkatese. Per Operatoren, te cilet blejne sherbimin e aksesit ne Internet nga Albtelecom, mund te ofrohen per te negociuar terma me te leverdisshme per elemente te kesaj oferte reference apo te ketij sherbimi te ofruar qe nuk jane subjekt i detyrimeve rregullatore sipas vendimit perkates te AKEP.

Ne kete faze sherbimi do te jete i disponueshem per sherbimet e teknologjise te aksesit ADSL.

2.1 Menyrat e sherbimit Bitstream nga Albtelecom

Sherbimi bitstream ndaj operatorit alternativ do te ofrohet nepermjet 2 niveleve te ndryshme. Secila prej tyre ka avantazhet e saj, por gjithashtu dhe kushte te ndryshme financiare. Referuar skemes se meposhtme dhe detyrimit te Albtelecom, ne vazhdim jepen detaje te ofrimit te sherbimit per *Opsionin 2- Nivel Ethernet* dhe *Opsionin 3-Nivel IP*.



Opsioni 2: Bitstream ne Nivel Etherneti

Sipas ketij opsioni operatori alternative duhet te kete VLAN-in/VLAN-et e tij. ISP do te kete nevojë qe te kete lidhje ne nivel etherneti tek POP i ALBtelecom. Ky opsion eshte shume i pershtatshem ne rastet kur ISP ka nevojë qe te mbuloje nje zone te vecante (e perbere nga shume DSLAM/MSAN). ISP do te kete mundesine qe nepermjet kesaj menyre t'i ofroje perdoruesve te tij fundor percaktimet dhe parametrat e duhur te paketes, por duhet qe te permbushe kerkesat e Albtelecom qe ta rrugezoje tek BRAS e tij (te deklaroje adresat IP te perdoruesve fundore, etj). Nepermjet ketij opsioni, ISP-se do ti jepet e drejta te ndertoje paketen dhe percaktimet e saj (si psh mund te ofroje nje vlere me te larte per upload ndaj perdoruesve te tij fundore).

Opsioni 3: Bitstream ne nivel IP

Operatori alternativ do te pozicionohet nepermjet ketij opsioni sikur te kete rrjetin dhe rrugezimin e tij. ISP duhet te kete lidhje me nje POP te Albtelecom ne nivel IP dhe trafiku do te rrugezohet nepermjet rrjetit MPLS te Albtelecom nepermjet metodave virtuale te kanaleve private (VPC). Ky opsion eshte ideal ne rastet kur ISP duhet te mbuloje nje rajon me te gjere (i perbere nga shume qytete) dhe gjithashtu kur nje ISP eshte duke operuar ne qytete ne distance me te larget duke pasur trafik me te gjere brenda rajonit, por me nje vendosje ne qender te centralizuar (e vendosur ne Tirane ose ne Durres).

ISP do te kete mundesi nepermjet ketij opsioni qe t'i ofroje perdoruesve te saj fundor percaktimin e paketes sipas karakteristikave qe deshirohen prej tij. ISP duhet te permbushe kerkesat e Albtelecom per rrugezimin tek BRAS i tij dhe se ISP, me qellim sigurimin e cilesise me te mire te sherbimit, duhet t'i raportoje Albtelecom-it si me poshte:

- Te dhenat e adreses se BRAS te ISP (per rrugezim me te mire),
- Te dhenat e adresave IP te perdoruesve fundore (per te siguruar nje cilesi me te mire sherbimi nga Albtelecom).

Nese ndonjera nuk i eshte raportuar Albtelecom-it, atehere nuk do te ofrohet "Bitstream ne nivelin IP".

2.2 Vecorite e sherbimit:

Vecorite e aksesit bitstream - bazuar ne sherbimet ADSL:

- Shoqerimi me sherbimin PSTN: Sherbimi Aksesit Bitstream do t'i percaktohet nje numer PSTN. Rendi i numrave te PSTN do te fumizohet nga operatori alternativ.
- Lloji i aksesit te internetit: Sherbimi Bitstream nepermjet ADSL nuk do te jete nje sherbim i dedikuar per perdorues, por do te shpemdahet sipas kohes/volumit dhe perdorimit dhe perkufizimit te sherbimit ADSL.
- Lloji i medias fizike: Sherbimi ADSL duhet te ofrohet vetem nepermjet telave te bakrit te llojit me dy fije per aksesin ne linjen fundore (local loop) deri tek kutija shpemdarese (DSLAM/MSAN) dhe tek perdoruesi fundor nga ana tjetere. Detajet e metejshme te kabllimit te miratuar do te gjenden sipas "Kerkesat teknike te detajuara" me poshte.
- Teknologjia e mbeshtetur: Sherbimi Bitstream duhet te perputhet me standartet e ITU dhe ETSI. Shikoni "Kerkesat teknike te detajuara".
- Shpejtesia Broadband: Sherbimet e ofruara per rishitje tek perdoruesit fundor duhet te kene te njejten shpejtesi si produkti ADSL. Operatori mund te kerkoje shpejtesi te tjera per ADSL sipas opsioneve 1 dhe 2.
- Modemat (terminalet) e perdorur: Operatori alternativ eshte pergjegjes per pajisjen e perdoruesit fundor. Albtelecom eshte pergjegjes per modemat vetem ne rastin kur perdoruesi fundor ka portuar (por kjo do te ndjehet proceduren e pergjithshme te portimit). Modemat e ofruar nga ISP ndaj perdoruesit fundor duhet ti permbushin kerkesat e specifikuara sipas "Kerkesat e detajuara teknike" dhe parametra te tjere te rrjetit Albtelecom, si dhe duhet qe te testohen teresisht nga operatori alternativ dhe nese operatori alternativ duhet te kerkoje asistencen lidhur me testimin e modem-it; kjo do te mundesohet nga Albtelecom nepermjet nje cmimi shtese (i paraqitur ne aneksin e cmimeve).
- Perdoruesi fundor IP: Te gjitha adresat IP te ofruara perdoruesit fundor duhet te jene publike dhe statike. Operatori alternativ duhet t'i siguroje Albtelecom-it informacionin e perdituar ne lidhje me IP-te e perdoruesit fundor dhe rrugezimit te IP-ve.
- Perdorim i drejte (fair usage). Perdorimi i vecante i drejte do te zbatohet ne te gjitha opsionet (sipas volumit te transferuar). Sapo te arrihet niveli i drejte i perdorimit, politikat e perdorimit te internetit te Albtelecom do te jene te detyrueshme.

2.3 Kerkesat teknike te detajuara:

Kerkesat teknike fizike:

Kabllot Nentokesore /Ajrore (Humbjet Tipike)

Lloji i kabllit	Futja e shuarjes
Diametri i Konduktorit	@300 kHz dB/km
	ADSL/ADSL 2+
0.4 mm	14
0.5 mm	12
0.6 mm	10

Parametrat e teknologjise dhe perputhshmeria:

Sherbimi i ofruar eshte ADSL:

- Kategoria II e REKOMANDIMEVE TEKNIKE TE ITU-se G.992.1: Aneksi -A
- LINJA DIXHITALE ASIMETRIKE E ABONENTIT (ADSL) MARRES-TRANSMETUES dhe G.992.5 Aneksi-A / Aneksi-M ose LINJA DIXHITALE ASIMETRIKE E KLIENTIT (ADSL2plus) MARRES- TRANSMETUES.
- ETSI (Instituti European i Standarteve te Telekomunikacionit) rekomandimet mbi Zhurmat. Modelet sipas Specifikimeve ETSI - ETR328.
- ETSI TS 101 388 – Linja Dixhitale Asimetrike e Abonentit (ADSL) – kerkesat e vecanta Europiane [ITU-T Rekomandimi G.992.1 i ndryshuar]
- ETSI TS 105 388 – Linja Dixhitale Asimetrike e Abonentit (ADSL2plus) – kerkesat e vecanta Europiane [ITU-T Rekomandimi G.992.5 i ndryshuar]

3. KUSHTET KONTRAKTUALE

Te gjitha kontratat e reja te aksesit Bitstream duhet te jene per nje minimum prej 12 muajsh. Kjo vlefshmeri i aplikohet edhe marreveshjeve te reja me operatore te caktuar.

4. CMIMET E SHERBIMIT BITSTREAM AKSES

Kjo pjese e ketij dokumenti shpjegon elementet perberes te cmimeve te sherbimit te aksesit Bitstream. Tarifa e sherbimit Bitstream perbehet nga elementet e meposhtem:

- 4.1 Tarifa fillestare e fillimit te sherbimit,
- 4.2 Tarifa per asistence dhe mbeshtetje per modemmat,
- 4.3 Pagesa garancise per sherbimin
- 4.4 Tarifa instalimit te aksesit per porte
- 4.5 Pagesa mujore per porte,
- 4.6 Tarifa dhe komisione te tjera

4.1 Tarifa fillestare e fillimit te sherbimit

Sherbimi aksesit Bitstream kerkon nje trajnim dhe mbeshtetje nga Albtelecom te stafit dhe punonjesve te operatorit alternative. Tarifa fillestare e fillimit te sherbimit faturohet vetem nje here per cdo operator te ri. Kjo tarife sherben per te mbuluar kostot nga ana e Albtelecom, si dhe per krijimin e parametrave te autentikimit, trajnimit ne sistemin e operimit te Bitstream, dhe shtjellimi i procesit te krijimit te abonenteve te rinj.

4.2 Tarifa per asistence dhe mbeshtetje per modemmat

Ky element ka te beje me pagesen qe operatori alternativ i paguan Albtelecom, e tarifuar per 1 dite pune. Ky sherbim perfshin testimin dhe miratimin e nje pajisje te re (modem, router) nga ana e

Albtelecom, i pajisjeve qe operatori do te perdore per sherbimin e Bitstream. Operatori alternativ nuk eshte i detyruar te kryje testimin me personat e autorizuar nga ana e Albtelecom, operatori detyrohet qe pajisjet qe u shet klienteve fundore te jene konform specifikimeve teknike te rrjetit dhe protokolleve te rrjetit te Albtelecom.

4.3 Pagesa e garancise per sherbimin

Pagesa e garancise aplikohet per te gjitha opsionet e sherbimit. Operatori alternativ duhet ta paguaje kete tarife si nje depozite ne nje bankat e parashikuara nga Albtelecom.

4.4 Tarifa e instalimit te aksesit per porte

Tarifa e instalimit te aksesit per porte i aplikohet portave te perdorura nga abonentet, ose per nje porte ne nivel transmetimi (opsioni 2 apo 3), dhe paguhet 1 here ne momentin e lidhjes se cdo porte te kerkuar nga operatori Alternativ.

Mundesia e realizimit te te gjitha kerkesave te operatorit do te varet nga perdorimi aktual i rrjetit te Albtelecom, dhe mund te ndodhe te kete raste kur sasia dhe vellimi i kerkuar te mos ofrohen nga Albtelecom.

4.5 Pagesa mujore per porte

Ne baze te opsionit te zgjedhur dhe kapacitetit per cdo porte, operatori alternative apo ISP kane detyrimin perkates financiar mujor.

ANEKS 3 LISTA E ÇMIMEVE BITSTREAM

Lidhur me detyrimin e Albtelecom per te ofruar akses broadband ne Ethernet dhe IP Level, ne vazhdim jepen tarifat perkatese per tu paguar nga Operatoret Alternative per pikat 4.1-4.5 pershkruar ne Aneksin 2 “Pershkrimi i produktit”.

Te gjitha tarifat e paraqitura ne kete Oferte Reference jane ne Leke.

- Tarifat per sherbimin Bitstream per elementet “**Tarife fillestare e sherbimit** (per operator)”, “**Tarife per asistence e mbeshtetje per modem** (per dite pune)”, dhe “**Pagesa e garancise per sherbimin** (pavaresisht opsionit te zgjedhur)” jepen ne tabelen nr.1 me poshte:

Tabela 1- Tarifat per pikat 4.1-4.3, ne Aneksin 2

Pershkrimi	Tarifa ne Leke
Tarifa fillestare e fillimit te sherbimit (per operator)	280,000
Tarifa per asistence dhe mbeshtetje per modem (per dite pune)	14,000
Pagesa garancise per sherbimin (cilindo opsion)	42,000

Shenim: Tarifat e mesiperme nuk perfshijne TVSH

- Tarifat per sherbimin Bitstream per elementet “**Tarife e instalimit te aksesit per porte** (nje here)” dhe “**Pagesa mujore e lidhjes per porte**”, do te pasqyrohen me poshte per secilin nga nivelet e ofrimit te Bitstream, Ethernet dhe IP level.

Opsioni 2: Bitstream ne nivel Ethernet

Bitstream ne nivel Ethernet, perbehet nga kapaciteti i transmetimit qe i nevojitet operatorit alternativ ne menyre qe t’u ofroje sherbimin bitstream klienteve te tij.

Tabela 2_Ethernet _ Tarifa e instalimit te aksesit per porte

Pershkrimi	Deri ne 100 porta	Mbi 100 porta
	Tarifa e instalimit/porte (leke)	Tarifa e instalimit/porte (leke)
Instalim i aksesit	2,500	2,200

Shenim: Tarifat e mesiperme nuk perfshijne TVSH

Tabela 3 Ethernet Pagesa mujore per porte

Referenca Produkti i Albtelecom			Produkti Bitstream Ethernet		
ADSL	Shpejtesia Doënload (Mbps)	Shpejtesia Upload (kbps)	Kapaciteti doënload/upload ne Mbps/kbps	Tarifa Mujore Lek/muaj/porte	Tarifa Mujore Lek/muaj/porte
				deri ne 100 porta	> 100 porta
2 Mbps Unlimited	2 Mbps	256 kbps	2 Mbps / 256 kbps	458	412
4 Mbps Unlimited	4 Mbps	512 kbps	4 Mbps / 512 kbps	610	548
6 Mbps Unlimited	6 Mbps	768 kbps	6 Mbps / 768 kbps	750	676
8 Mbps Unlimited	8 Mbps	1 Mbps	8 Mbps / 1 Mbps	999	901
10 Mbps Unlimited	10 Mbps	1 Mbps	10 Mbps / 1 Mbps	1,077	969
12 Mbps Unlimited	12 Mbps	1 Mbps	12 Mbps / 1 Mbps	1,188	1,067
16 Mbps Unlimited	16 Mbps	1 Mbps	16 Mbps / 1 Mbps	1,366	1,234

Shënim: Tarifat nuk përfshijnë TVSH

Opsioni 3: Bitstream ne nivel IP

Bitstream ne nivel IP, perbehet nga kapaciteti i transmetimit qe i nevojitet operatorit Alternativ ne menyre qe t'iu ofroje sherbimin bitstream klienteve te tij.

Tabela 4 Tarifa e instalimit te aksesit per porte

Pershkrimi	Deri ne 100 porta	Mbi 100 porta
	Tarifa e instalimit /porte (leke)	Tarifa e instalimit/porte (leke)
Instalim i aksesit	2,800	2,500

Shënim: Tarifat e mesiperme nuk perfshijne TVSH

Tabela 5 - IP Level Pagesa mujore per porte

Referenca Produkti i Albtelecom			Produkti Bitstream Ethernet		
ADSL	Shpejtesia Doënload (Mbps)	Shpejtesia Upload (kbps)	Kapaciteti doënload/upload ne Mbps/kbps	Tarifa Mujore Lek/muaj/porte	Tarifa Mujore Lek/muaj/porte
				deri ne 100 porta	> 100 porta
2 Mbps Unlimited	2 Mbps	256 kbps	2 Mbps / 256 kbps	537	484
4 Mbps Unlimited	4 Mbps	512 kbps	4 Mbps / 512 kbps	716	644
6 Mbps Unlimited	6 Mbps	768 kbps	6 Mbps / 768 kbps	881	793
8 Mbps Unlimited	8 Mbps	1 Mbps	8 Mbps / 1 Mbps	1,175	1057
10 Mbps Unlimited	10 Mbps	1 Mbps	10 Mbps / 1 Mbps	1,265	1,139
12 Mbps Unlimited	12 Mbps	1 Mbps	12 Mbps / 1 Mbps	1,395	1,256
16 Mbps Unlimited	16 Mbps	1 Mbps	16 Mbps / 1 Mbps	1,606	1,439

Shënim: Tarifat nuk përfshijnë TVSH

ANEKSI 4 FATURIMI DHE PAGESAT

1. Operatori do të jetë përgjegjës për t'i paguar Albtelecom-it të gjitha tarifatat e përcaktuara në Listën e çmimeve të Albtelecom që rrjedhin nga blerja e Shërbimeve Bitstream sipas kësaj Oferte Reference.
2. Intervalet e faturimit do të përcaktohen për çdo shërbim.
3. Operatori mund të paguajë TVSH për çdo pagesë që rrjedh nga kushtet e kësaj Oferte Reference.
4. Nëse nuk është shprehur ndryshe në këtë Oferte Reference faturat janë të pagueshme në Leke. Faturat do të pagohen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga data e leshimit, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Oferte Reference.
5. Albtelecom do të japë informacionin e nevojshëm për çdo faturë.
6. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me pagesat/faturat do të jetë subjekt i parashikimeve të nenit 9 të kësaj Oferte Reference.

ANEKS 5
FORMULARI I GARANCISE

GARANCI PAGESE

PERFITUESI: ALBTELECOM sh.a, Autostrada Tirane – Durres, km7,
Kashar, Tirane

SHUMA: _____leke (shuma ne shifra dhe fjale)

PER LLOGARI TE APLIKANTIT: _____(emri dhe adresa)

QELLIMI I MBULIMIT: Detyrimet Finaciare te Marrevshjes se Aksesit me Shumice
Bitstream nr.....dt.....

Ne zbatim te Marrevshjes Nr.....dt..... me objekt **Ofrimin e Sherbimeve te Aksesit Bitstream**, Ne, Banka _____ jemi ne dijeni qe per te garantuar **permbushjen e detyrimeve financiare**, nga ana e Aplikantit _____(emri) me korrektesi, Aplikanti eshte i detyruar te vendose nje garanci financiare ne nje Banke Shqiptare te nivelit te dyte ne favor te Albtelecom.

Me kerkese te _____ (emri) Ne, _____Banka sh.a (adresa), marrim persiper ne menyre te parevokueshme dhe te pakushtezuar qe si detyruesi kryesor dhe jo vetem si pale garante, sapo Albtelecom sh.a te beje kerkesen e pare me shkrim, te paguajme brenda 3 diteve pune, cdo shume te faturave (detyrimeve financiare) te papaguara nga aplikanti kundrejt Albtelecom deri ne vleren totale te garancise _____leke (shuma ne shifra dhe fjale), pa kerkuar shpjegime dhe pa pasur asnje lloj te drejte kundershimi nga ana jone, duke permendur ne kerkese mospermbushjen e kushteve te Marrevshjes se aksesit me Shumice Bitstream.

Me kete garanci sigurojme perfituesin Albtelecom sh.a se nuk eshte nevoja t'i drejtoheni me pare apo t'i kerkohet miratim paraprak kontraktuesit per te realizuar pagesen sipas kerkeses suaj.

Shuma totale e kesaj garancie do te reduktohet ne menyre automatike per cdo pagese te kryer sipas kesaj garancie.

Kerkesa juaj me shkrim, per pagese duhet te paraqitet ne _____ Banka sh.a, ne adresen e meposthme:

Banka sh.a

(adresa e Bankes leshuese te garancise bankare)

Kerkesa per pagese e garancise do te konsiderohet si e kryer ne momentin qe ne kemi kerkesen tuaj me shkrim per pagese tek adresa jone e siperpermendur.

Deklarojme gjithashtu, se asnje shtese apo ndryshim i kushteve te marrevshjes, per te cilen ju mund te bini dakort me kontraktuesin, nuk na cliron nga detyrimet e kesaj Garancie.

Kjo Garanci Financiare do te jete e vlefshme per nje periudhe dymbedhjete (12) mujore, duke filluar nga dita e nenshkrimit te Marrevshjes dhe do te rinovohet (do te dorezohet nje e re), nje muaj perpara afatit 12 mujor, sipas percaktimeve ne Marrevshjen e Aksesit me Shumice Bitstream.

Kjo garanci leshohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

_____ Banka sh.a
(firmat e autorizuara te bankes)

ANEKS 6

MARREVESHJA E NIVELIT TE SHERBIMIT

1. TE PERGJITHSHME

- 1.1 Marreveshja e Nivelit te Sherbimit (ketaj e tutje SLA) nenshkruhet mes Albtelecom dhe Operatorit Perfitues te sherbimit Bitstream dhe eshte pjese integrale e Ofertes Reference te Sherbimit Bitstream te Albtelecom.
- 1.2 SLA pershkruan rregullat ne lidhje me shfrytezimin dhe mirembajtjen mes rrjetit te Albtelecom dhe rrjetit te Operatorit Perfitues, analizon procedurat qe duhet te aplikohen nga te dyja Palet per funksionimin e rregullt te sherbimit Bistream si dhe shkembimin e informacionit te nevojshem per matje, teste dhe administrimin e defekteve.
- 1.3 Albtelecom dhe Operatori Perfitues garantojne qe cilesia e sherbimit te ofruar Bitstream qe pershkruhen ne Oferten Reference te Aksesit Bistream mes paleve do te jete e njejte me cilesine e sherbimit te ofruar abonenteve te tyre dhe ne perputhje me rekomandimet e ITU-T-se dhe ETSI-se.
- 1.4 Me qellim bashkepunimin sa me te mire per shfrytezimin dhe mirembajtjen e rrjetit, Palet do te vendosin personat pergjegjes te kontaktit per administrimin e Marreveshjes se Aksesit Bitstream.
- 1.5 Percaktimet e parametrave te ofrimit te sherbimit SLA dhe pikat e proceseve qe lidhen me kete SLA do te jene si me poshte, pervec kur eshte rene dakort ndryshe ne Marreveshje dhe ne pershkrimin e Produktit Bitstream.

2. PERKUFIZIME

Difekt

Difekt ne Sherbimin Bitstream do te konsiderohet cdo pengese ne ofrimin e sherbimit Bitstream nje abONENTI, nderkohe qe ai vazhdon te beje dhe te marre thirrje ne dhe nga rrjeti i komutimit i Albtelecom.

Verifikimi

Data nga e cila te gjitha linjat e porosise (urdherit) jane verifikuar me sukses sipas sistemeve te bazes se te dhenave te klienteve te Albtelecom. Gjendja e porosise ne Gateëay DSL ne daten e verifikimit do te ndryshohet nga "urdher verifikimi" ne "fillimi i fumizimit". Afati i SLA do te filloje me konfirmimin e verifikimit me sukses te porosise Bitstream te njoftuar ne gateëay.

Data e fillimit

Data e fillimit eshte data e caktuar e dorezimit te nje Porte Bitstream.

Realizimi

Porosia Bitstream do te konsiderohet e perfunduar menjehere pasi Albtelecom realizon porosine dhe gjendja e urdherit do te ndryshoje nga "fillim i fumizimit" ne "realizim" sic njoftohet ne Gateway. Koha e SLA do te ndaloje me konfirmimin e realizimit te porosise tek Operatori Perfitues sic kerkohet ne gateway.

Porta Bitstream

Porta Bitstream do te siguroje Produktin Bitstream ne nje linje aktive PSTN qe eshte e lidhur ne rrjetin e Albtelecom.

Produkt

Produkt eshte cdo Sherbim Bitstream i dhene ne Pershkrimin e Produktit i cili mund te perditsohet here pas here.

3. NIVELI I OFRIMIT TE SHERBIMIT

Albtelecom angazhohet te kryeje 100% te porosive te sigurimit te Portes Bitstream sipas dates se fillimit te rene dakort mes paleve dhe pas verifikimit te suksesshem sic percaktohet ne kete SLA.

Bitstream ne nivelin Ethernet dhe IP

Albtelecom do te publikoje cdo tre muaj statistikat e perdorimit ne kohen e pikut te nxjerra nga rrjeti i tij Core NGN, per te treguar qe Produkti Bitstream ne nivel Ethernet dhe IP eshte nje sherbim i pa bllokueshem.

4. MOSREALIZIMI I OFRIMIT TE SHERBIMIT

Per cdo dite pune vonese per sigurimin e sherbimit perkundrejt Dates se Fillimit, Albtelecom do te jete i detyruar te paguaj ne nje shkalle te ndryshueshme nje penalitet per mosrealizimin e sigurimit te Portave Bitstream.

Si penalitet per mosofrimin e sherbimit, 50% e tarifes se lidhjes do te rimbursohet ne menyre lineare per 'A Dite'. Pas mbarimit te kesaj periudhe do te faturohet nje penalitet ekuivalent me X% te tarifes se qerase ditore (ku X eshte 100%).

Tabela 1: Penaliteti per mosrealizimin e sherbimit-"A Dite"

Pershkrimi	Standartet e ofrimit te Sherbimit	Ditet qe duhet ti shtohen Dates se fillimit per te perfituar "A"
Porta Bitstream Porosia e dhenies	100% sipas Dates se Fillimit pas njoftimit te urdherit te vertetimit te suksesshem vetem nese eshte subjekt i kushteve sic percaktohet ne Shtesen 1	5 Dite Pune




Fig. 1: Mosrealizimi i ofrimit te Sherbimit

Albtelecom do te clirohet nga pagesa e penaltetit nese mungesa e ofrimit te sherbimit eshte subjekt i kushteve te treguara ne nenin 10 te ketij aneksi.

Nje zbritje 50% e tarifes mujore te linjes do te aplikohet per cdo rast kur Albtelecom do te deshtojte ne arritjen e minimumit te nivelit te diponueshmerise se sherbimit ne nje zone te caktuar.

Performanca e rrjetit te Albtelecom do te vleresohet ne baze tremujori, me qellim qe te percaktohet se pragu 99.5% i disponueshmerise se sherbimit eshte arritur.

Pershkrimi	Siguria e Sherbimit	Penaliteti per mosrealizim
Portat Bitstream	99.5% Disponueshmeri e Sherbimit	50% e qerase mujore te linjes

Skema e udhezimit per pagesen e krediteve te penaltetit jepet ne nenin 11 te ketij aneksi.

5. TREGUESIT E CILESISE SE SHERBIMIT

Percaktimet lidhur me pikat e proceseve dhe parametrave te cilesise se sherbimit te kesaj SLA, nese nuk eshte percaktuar ndryshe ne Marreveshje dhe ne Pershkrimin e Produktit Bitstream, jane si me poshte:

Orari i Punes

Orari i punes me qellim pranimin e difektit percaktohet cdo dite nga ora 08:00 deri ne oren 16:00 me perjashtim te dites se Shtune, te Diele dhe festave zyrtare.

Koha e Riparimit

Koha e Riparimit eshte intervali kohor ndermjet kohes ne te cilen difekti eshte pranuar nga Albtelecom ne perputhje me procedurat e raportimit te difektit dhe kohes se shenuar nga Albtelecom si "eliminim i perhershem".

Me perfundimin e riparimit, difekti do te konsiderohet "i eliminuar perkohesisht", dmth koha ndalet derisa eliminimi i difektit te jete pranuar nga klienti ose te kene kaluar tre ore pune nga koha e njoftimit te klientit per "eliminimin e perkohshem".

Ne rast se difekti eshte pranuar nga klienti ose kane kaluar tre ore nga momenti i njoftimit te klientit per "eliminim te perkohshem", difekti do te konsiderohet "i eliminuar perfundimisht" se bashku me nje kod eliminimi perfundimtar dhe formulari i difektit mbyllet perfundimisht.

Nese klienti pergjigjet me nje refuzim te riparimit, matja e kohes dhe puna e riparimit do te rifillojne. Me perfundimin e riparimit, difekti do te konsiderohet si "i eliminuar perkohesisht", klienti do te njoftohet, difekti pezullohet dhe procesi do te perseritet.

Gadishmeria e Sherbimit

Koha vjetore "ne sherbim" te nje qarku shprehet ne perqindje dhe matet sipas formules:

$$[\text{Numri total i oreve ne vit}] - [\text{Numrin total te oreve "jashte sherbimit"}] / [\text{Numrin total te oreve ne vit}].$$

Jashte sherbimit

Eshte diferenca ne kohe ndermjet momentit te "eliminimit te perhershem" dhe momentit te raportimit te difektit me kohen jashte orarit te punes dhe kohen e pezullimit te defektit.

Raportimi i Cilesise se sherbimit

Frekuenca e raportimit te gadishmerise te sherbimit eshte 3 mujore dhe do te aplikohet ne te gjitha difektet e portave Bitstream mbi nje baze retrospektive nga data e ofrimit te sherbimit. Periudha e matjes eshte viti i meparshem (4 tremujore), te altemuara.

Gadishmeria e Sherbimit do te matet mbi 7 x 24 ore ne dite duke perdorur formulen e meposhtme per te gjitha qarqet brenda fusheveprimit te SLA Bitstream, pavaresisht nga produkti:

$$[8766 - (\text{kohen jashte sherbimit})] / 8766$$

- Koha jashte sherbimit do te perjashtoje cdo kohe pezullimi.
- Koha e pergjigjes do te matet vetem mbi oret e punes.
- Te gjitha llogaritjet do te behen mbi kohen e "eliminimit te perhershem" te defektit.
- "Kodi i eliminimit" qe shoqeron "eliminimin e perhershem" percakton perfshirjen e difektit ne masen e gadishmerise.
- Per tu mbrojtur nga refuzimet e pajustificuara te riparimit, ne rastin kur refuzimi i riparimit rezulton sipas percaktimit te Albtelcom nje refuzim i shkaktuar nga faktor te jashtem te rrjetit te Albtelcom, "kodi i eliminimit" final do t'a reflektojete kete dhe defekti do te perjashtohet nga llogaritjet e gadishmerise.
- Nje qark mund te jete subjekt vetem i nje penaliteti ne periudhen e matjes, dmth nje qark subjekt i nje penaliteti ne nje 3 mujor nuk do te jete subjekt i tille perseri ne 3 mujorin tjeter. Ne rast te verifikimit te nje defekti te ri ne nje tremujor tjeter llogaritjet do te behen perseri mbi kete difekt.

Per shembull:

Ne nje periudhe te dhene matjesh, nese nje qark ka tre difekte ne nje hark kohor 12 mujor, shuma e ketyre difekteve do te perbeje "kohen jashte sherbimit" per ate periudhe. Nese kjo kohe shkakton penalitet, keto tre difekte do te evidentohen. Ne rast se ky qark do te kete difekte ne periudhat e matjeve pasardhese, koha e ketyre tre difekteve do te perjashtohet nga llogaritja e

"kohes jashte sherbimit" te ketij qarku, e cila do te perfshije automatikisht difektet e reja per kete qark. Nga ana tjetere, nese shuma e ketyre tre defekteve nuk shkakton ndonje penalitet, asnje nga defektet nuk do te evidentohet dhe cdo difekt qe do te ndodhe ne perudhat e matjeve pasardhese do te perfshihet ne llogaritjet e penalitetit se bashku me keto tre difekte.

6. GARANTIMI I SHERBIMIT

Albtelecom do te siguroje nivelet e sherbimit per garancine e Sherbimit Bitstream subjekt i kesaj SLA si me poshte:

- Marrja dhe Pranimi i Difektit do te behet brenda orarit te punes nga ora 08:00 deri 16:00 nga e Hena deri te Premten duke perjashtuar ditet e shtuna, te diela si dhe festat zyrtare.
- 100 % e Raporteve te Difekteve Bitstream te rregjistruara do te kene nje pergjigje fillestare per difektin brenda 4 oreve pune nga paraqitja e defektit.
- Portat Bitstream do te kene nje disponueshmeri te sherbimit ne vleren 99.5%.
Disponueshmeri e Sherbimit eshte koha vjetore "ne sherbim" e nje qarku e shprehur ne%.

Nivelet e sherbimit te dhena me lart do te aplikohen, pervec nese do te ndikohen nga kushtet e dhena ne nenit 10 te kesaj SLA.

7. CMIMI

Marreveshja e Nivelit te Sherbimit (SLA) per Bitstream eshte nje oferte e tarifuar.

8. RAPORTIMI

Albtelecom do t'i jape Operatorit Perfitues nje raport per parametrat e garancise se sherbimit. Raporti per Ofrimin/Dhenien e Sherbimit do te behet cdo muaj dhe raporti per Disponueshmerine e Sherbimit cdo tremuaj.

Raportet do te dorezohen brenda 30 diteve kalendarike te muajit ose tremujorit pasardhes, sipas rastit.

Raportet do te paraqesin nje permbledhje te parametrave aktuale te performances duke i krahasuar ato me parametrat e kuotuar te sigurise se sherbimit.

9. ÇLIRIMI NGA PENALITETI

Albtelecom do te clirohet nga pagesa e penalitetit nese do te realizoje ofrimin 90% te Portave Bitstream nje Operatori Perfitues te vecante brenda limiteve kohore te SLA. Performanca e rrjetit te Albtelecom do te vleresohet çdo muaj per te percaktuar qe pragu 90% eshte arritur.

Albtelecom do te lirohet nga pagesa e penalitetit nese do te jete i suksesshem ne garantimin e sherbimit te SLA ne 95% te linjave te nje Operatori Perfitues ne nje tremujor te dhene.

10. PERJASHTIMET NGA PENALITETI PER OFRIMIN E SHERBIMIT

1. Pagesa e Penaliteteve per performancen e ofrimit te sherbimit eshte objekt i kushteve te meposhtme:
 - a) Ofrimi i sherbimit Bitstream eshte i varur ne nje linje ekzistuese PSTN "ne sherbim" te lidhur ne rrjetin e Albtelecom.
 - b) Angazhimet e ofrimit te sherbimit SLA per Portat Bitstream nuk garantohen kur lloji i lidhjes eshte i ndryshem nga ai i percaktuar nga sherbimi. Nese nje kerkues aksesit kerkon Sherbimin Bitstream jashte percaktimeve te kesaj marreveshjeje, vonesa ne ofrimin e sherbimit nuk do te lidhet me kete SLA (p.sh. migrimi i ISDN ne Bitstream).
2. Perjashtimi nga Penaliteti per Sigurine e Sherbimit

Nivelet e sherbimit te vendosura ne kete SLA nuk do te aplikohen kur deshtimi i Sherbimit Bitstream per te arritur objektivat e performances rezulton nga:

- a) Deshtimi i Operatorit Perfitues ne plotesimin e ndonje prej dispozitave te detajuara te Pershkrimin te Produktit te Sherbimit Bitstream ADSL, Marreveshjes ose detyrimeve te SLA.
- b) Shkelje e çfaredo pjese te Marreveshjes nga Operatori Perfitues.
- c) Pezullimi i Sherbimit sipas dispozitave te Marreveshjes.
- d) Deshtimi i Operatorit Perfitues ne Lidhjen e Sherbimit Bitstream.
- e) Operatori Perfitues deshton te provoje qe nje difekt eshte jashte rrjetit te tij perpara se te ngreje kete difekt tek Albtelecom.
- f) Nje difekti te lidhur me sherbimin PSTN te abonentit.
- g) Nje difekt ndodh si rezultat i nderhyrjes ne linje te shkaktuar nga nje kopje e afert. Keto raste do te trajtohen sipas CLFMP. (Cooper Loop Frequency Management Plan)

Per qellime te llogaritjes se zbritjes se vleres se penalitetit, Albtelecom do te perjashtoje ato difekte ku mungesa e diponueshmerise eshte shkaktuar nga difekte qe i atribuohen stuhive, rrufeve, permbytjeve, demtimeve nga te tretet, apo vandalizmit.

11. LINJAT UDHEZUESE PER PAGESEN E KREDITEVE TE PENALITETIT

1. Albtelecom do t'i jape Operatorit Perfitues deklaratat e penaliteteve ne muajin pasardhes te muajit ose tremujorin pasardhes, sipas rastit. Deklarata do te behet ndermjet paleve gjate muajit qe pason nxjerrjen e deklarates se penalitetit me kryerjen e pageses ne ciklin tjeter te faturimit.
2. Ne rast se Operatori Perfitues eshte i mendimit se nje detyrim penaliteti eshte llogaritur jo sakte atehere nje ankese me shkrim duhet te dergohet ne Albtelecom,
3. Ne rast te nje pyetje, ceshtje, etj, cdo dokumentacion mbeshtetes duhet te furnizohet/dergohet brenda 10 ditesh pune nga dita e kerkeses se Albtelecom,
4. Cdo rregullim do te kthehet ne forme kredie ne llogarine shoqeruese te ankeses.

12. KOHA E PEZULLIMIT TE PENALITETIT

Rrethanat ne te cilat nje difekt nuk mund te vazhdoje t'i adresohet per zgjidhje Operatorit

ofruer te Aksesit dhe difekti eshte i bllokuar jane si me poshte:

- Albtelecom nuk mund te marre bashkepunimin e Operatorit Perfitues ne avancimin e zgjidhjes se difektit.
- Nje formular difekti merr gjendjen "riparim i perkohshem"
- Procedimi per difektin mund te rezultoje ne nje rrezik per shendetin dhe sigurine, parandalimi i te cilave nuk do te ishte realisht i mundur te parashikohej nga Albtelecom.
- Eshte kerkuar nga Operatori Perfitues ose abonenti te bllokohet difekti.
- Forca Madhore, sic percaktohet ne marreveshje.